

Muhammed Ibn Salih el-Uthejmin

- LIBRI I DIJES -



Libri i Dijes

Muhamed ibën Salih el-Uthejmin

Burimi: “Kitabul Ilm”

Përktheu:

Dr. Bledar Karaj el-Albani

Parathënie:

Falënderimi i takon vetëm Allahut. Vetëm Atë falënderojmë, Atij i kërkojmë ndihmë dhe falje të gjynaheve tona. I kërkojmë mbrojtje Allahut prej të keqes së veteve (shpirtrave) dhe punëve tona. Atë të cilin e udhëzon Allahu, nuk ka kush e humb dhe atë të cilin humb Allahu, nuk ka kush e udhëzon.

Dëshmoj se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut, Një e i Pashoq dhe se Muhamedi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) është rob dhe i Dërguari i Tij.

Libri qe keni në duar është një version i shkurtuar i librit të dijetarit të madh Muhamed ibën Salih el Uthejmin (RahimehUllah), me titull **“Libri i dijes”**.

Shkurtimi që kemi bërë në libër është mospërmendja e disa fetvave rreth dijes të dhëna nga shejhu, të cilat i kanë mbledhur botuesit e librit, Shtëpia Botuese **“Darul Minhaxh”**, në Kajro. Po kështu, nuk kemi përmendur disa letra dhe porosi të shejhut,

në mesin e të cilave ka përsëritje të shumë fjalëve të përmendura më parë. Pra, mund të themi se kemi përkthyer gjërat e papërsëritura dhe kemi lënë pa përkthyer shtojcat që i janë bërë subjektivit kryesor të librit.

Libri përmban këshilla dhe udhëzime për nxënësin e dijes, për të cilat ai ka shumë nevojë dhe nuk mund të bëjë pa to, nëse dëshiron të ndjekë rrugën e dijes dhe t'ja arrijë synimit në rrugën sa më të shkurtër dhe të saktë.

Lusim Allahun të na japë dije të dobishme dhe të na bëjë dobi me dijen që na jep! Ai është Zot i kësaj dhe Plotfuqishëm për gjithçka.

Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dërguarin tonë Muhamedin, familjen dhe shokët e tij!

Kapitulli i parë.

Përkufizimi i dijes, vlera e saj dhe gjykimi për kërkimin e saj.

01. Përkufizimi i dijes:

Në kuptimin gjuhësor, dija është e kundërta e injorancës. Përkufizimi i saj mund të ishte kështu: **“Perceptimi i diçkaje ashtu si është në realitet me një perceptim të sigurtë.”**

Ndërsa në kuptimin terminologjik, disa dijetarë kanë thënë se dija është të njohurit, e cila është e kundërta e injorancës. Ndërsa disa të tjerë thonë: Dija është më e qartë se sa të pasurit nevojë për përkufizim.

Por ajo që na intereson neve është dija fetare, d.m.th: “Dija të cilën Allahu ia zbritur të Dërguarit të Tij prej provave dhe udhëzimeve.”

Pra, dija e lavdëruar dhe pozitive është dija e Shpalljes, dija të cilën e ka zbritur Allahu. I Dërguari i Allahut (sal-lAllahu

‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: **“Atij të cilit Allahut i do të mirën, Ai i jep atij kuptim (dije) në Fe.”** [E transmeton Buhariu.]

Ai (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) gjithashtu thotë: “Pejgamberët nuk kanë lënë trashëgimi ar e argjend, por kanë lënë dijen dhe kushdo që e merr atë, ai ka trashëguar një pasuri të madhe.” [E transmeton Ebu Daudi dhe Tirmidhiu.]

Dhe siç dihet, ajo që kanë lënë trashëgimi Pejgamberët është dija rreth Sheriatit të Allahut të Madhëruar dhe jo ndonjë dije tjetër. Pejgamberët (sal- lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) nuk u kanë lënë trashëgim njerëzve shkencat e industrisë e çfarë lidhet me të. Madje kur i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) emigroi në Medine dhe i gjeti njerëzit që t’i pllenonin palmat, kur pa lodhjen e tyre për kryerjen e kësaj gjëje, ai u tha atyre një fjalë nga e cila kuptohet se nuk ishte nevoja për atë që bënëin ata me palmat, kështu që ata e lanë plenimin e tyre, por më pas palmat filluan të prishen, atëherë ai (sal- lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) u tha atyre: **“Ju jeni më**

të ditur për çështjet e dynjasë tuaj.” [E transmeton Muslimi.]

E sikur kjo lloj njohurie të ishte nga lloji i dijes së lavdëruar, atëherë i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) do të ishte më i dituri i njerëzve në të, pasi që më i shumti njeri i cili lavdërohet për dijen dhe punën është i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem).

Kështu që, dija fetare është ajo dije e cila është e lavdëruar dhe poseduesi is ë cilës gjithashtu lavdërohet.

Mëgjithatë, unë nuk e mohoj faktin se edhe njohuritë e tjera kanë vlerë dhe dobi, por dobia e tyre është me dy prerësa: nëse ajo ndihmon në arritjen e bindjeve ndaj Allahut, në ndihmën e Fesë së Tij dhe u bën dobi robëve të Allahut, atëherë kjo është diçka e mirë dhe e dobishme për njerëzit. Të mësuarit e kësaj dijeje, në disa raste mund të jetë i obligueshëm, nëse ajo përfshihet në Fjalën e Allahut të Madhëruar: **“Dhe përgatisni kundër tyre gjithë fuqitë që keni, bashkë me kalorinë...”** [El Enfal: 60]

Shumë dijetarë kanë thënë se të mësuarit e shkencave të ndryshme të industrisë e të tjera, është detyrë e përgjithshme **(farz kifaje – detyrim mbi një pjesë të mjaftueshme individësh të një shoqërie të caktuar)**. Kjo sepse njerëzit kanë nevojë patjetër për enë gatimi dhe pirjeje, si dhe shumë gjëra të tjera të nevojshme për jetën e tyre të përditshme, e nëse nuk gjenden njerëz të aftë për ngritjen e atyre industrive, atëherë të mësuarit e kësaj dijeje është farz kifaje.

Kjo në fakt është pikë në të cilën dijetarët kanë kundërshtime, por megjithatë unë desha të them se dija e lavdëruar është dija fetare, e cila është të kuptuarit dhe të mësuarit e Librit të Allahut dhe Sunetin e të Dërguarit të Tij (sal-lAllahu ‘alejhi ue sellem). ndërsa fushat e tjera të dijës mund të jetë mjet për arritjen e të mirës ose të keqes, kështu që gjykimi për të është në varësi të përdorimit të asaj dijeje të caktuar.

02. Vlera e dijes:

Allahu i Madhëruar e ka lavdëruar dijen dhe poseduesit e saj, dhe i ka nxitur robët e Tij që të mësojnë dijen dhe të shtojnë sa më shumë nga ajo. Po kështu edhe në Sunetin e të Dërguarit të Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) gjejmë nxitje dhe lavdërim për këtë.

Dija është prej veprave më të mira dhe më i miri e më madhështori adhurim, nga adhurimet vullnetare, pasi që ajo është një lloj xhihadi në Rrugë të Allahut, sepse Feja e Allahut është ngritur mbi dy gjëra:

01. Dija dhe prova.

02. Lufta dhe shtiza.

Këto dy gjëra janë të domosdoshme dhe pa to, Feja nuk mund të ngrihet e të triumfojë, veçse më të dyja ato së bashku.

E para prej tyre është paraprirëse e të dytës, për këtë shkak i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) nuk e sulmonte ndonjë popull (**vendbanim**) veçse pasi t'u komunikonte atyre thirrjen për tek Allahu dhe Feja e Tij. Pra dija i paraprin luftës.

Allahu i Madhëruar thotë: “A është ai i cili është i nënshtruar i Allahut, i cili bie në sexhde e qëndron në falje gjatë orëve të natës duke pasur frikë botën tjetër dhe duke shpresuar për Mëshirën e Zotit të tij?!” [Ez Zumer: 9]

Pyetja e bërë në këtë ajet duhet patjetër që të ketë plotësuesin e saj, atë me të cilin bëhet krahasimi: **“A është ai i cili është i nënshtruar i Allahut, i cili bie në sexhde e qëndron në falje gjatë orëve të natës?”** d.m.th: A është ky i njëjtë me atë i cili nuk është i atillë, por pjesa e dytë e fjalisë nuk është përmendur, për arsye se ajo është i ditur, nënkuptohet. Pra, a është i njëjtë ai i cili i nënshtrohet Allahut dhe falet për të gjatë natës duke pasur frikë botën tjetër dhe duke shpresuar Mëshirën e Allahut, a është

ky njësoj me atë i cili është kryeneç në bindjen ndaj Allahut?!

- Përgjigja për këtë është: **“Jo, nuk janë njësoj.”**

Po vepra e këtij i cili i është nënshtruar Allahut, shpreson shpërblimin e Tij dhe ka frikë botën tjetër, a është vepra e tij rezultat i dijes apo rezultat i injorancës?

- Përgjigja për këtë është: Sigurisht që rezultat i dijes, pasi që në vazhdim të ajetit, Allahu i Madhëruar thotë: **“Thuaj: “A janë ata që dinë njësoj me ata që nuk dinë?” (Jo) Por janë vetëm njerëzit me arsye të shëndoshë ata të cilët me të vërtetë përkujtojnë.”** [Ez Zumer: 9]

Ai që di nuk është njësoj me atë që nuk di, ashtu si nuk është njësoj i gjalli me të vdekurin, ai që dëgjon me të shurdhërin, ai që sheh me të verbërin.

Dija është dritë me të cilën Allahu e udhëzon njeriun dhe e nxjerr atë nga errësira në dritë.

Me dijen, Allahu ngre atë që Ai do nga krijesat e Tij: “...që Allahu t’i lartësojë ata të

cilët besojnë dhe ata të cilëve u është dhënë dija në grada të larta.” [el Muaxhadele: 11]

Ndaj i gjejmë dijetarët objekt lavdërimi. Sa herë që ata përmenden, njerëzit i lavdërojnë ata, gjë e cila është ngritje për ta në këtë botë. Ndërsa në botën tjetër, ata do të ngrihen në grada në varësi të mundit që kanë dhënë në thirrjen për tek Allahu i Madhëruar dhe të vepruarit me dijen e tyre.

Robi i vërtetë i Allahut është ai i cili e adhuron Atë me dije të sigurtë dhe me njohje të qartë të së vërtetës. Kjo është rruga e të Dërguarit të Allahut (sal- lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): **“Thuaj: “Kjo është udha ime. Unë thërras për tek Allahu me dije të sigurt, unë dhe kushdo që më ndjek mua. Lavdi i goftë Allahut dhe unë nuk jam prej idhujtarëve.”** [Jusuf: 108]

Njeriu i cili pastrohet duke e ditur se kjo është udhëzim i Sheriatit, a është ky njësoj si ai i cili pastrohet sepse ka parë babanë apo nënën e tij të pastrohen?

Cili prej këtyre të dyve e vërteton më shumë adhurimin: një njeri i cili pastrohet

ngaqë e di se Allahu ka urdhëruar për t'u pastruar dhe se ajo është vepër e të Dërguarit të Allahut (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem), kështu që pastrohet në zbatim të urdhërit të Allahut dhe në pasim të të Dërguarit të Allahut (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem), apo dikush tjetër i cili pastrohet meqë kjo i është bërë zakon?

Përgjigja është: Sigurisht që i pari është ai i cili e adhuron Allahun me dije të sigurt. E si mund të krahason këta dy me njëri-tjetrin?! Megjithëse vepra e secilit prej tyre është e njëjtë, por ky e bën me dije e njohuri të plotë, duke shpresuar tek Allahu dhe me frikë për jetën e botës tjetër, si dhe duke e ndjerë se ai po ndjek shembullin dhe rrugën e të Dërguarit të Allahut (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem).

Doja të qëndroja pak në këtë pikë dhe të drejtoja një pyetje: A e ndjejmë dhe e çojmë në mendje kur marrim avdes, se ne jemi duke zbatuar Urdhërin e Allahut, i Cili thotë: **“O ju që keni besuar! Kur doni të**

kryeni faljen, lani fytyrat tuaja dhe duart tuaja (parakrahët) deri në bërryl, kaloni duart e lagura mbi kokat tuaja, lani edhe këmbët deri në nyje (kyçe).” [El Maide: 6]

A e kujton njeriu këtë ajet kur ai merr avdes dhe se ai merr avdes për të zbatuar Urdhërin e Allahut? A e përmend ai se kjo është edhe mënyra e avdesit të të Dërguarit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) dhe se ai po pason të Dërguarin e Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem)?

Përgjigja është: “Po.” Në fakt disa nga ne e përmend këtë. Kjo është edhe arsyeja për të cilën ne e kemi të detyrueshme që kur kryejmë adhurimet, t’i kryejmë ato me qëllim që të zbatojmë Urdhërin e Allahut, që të realizojmë me këtë sinqeritetin dhe që të jemi pasues të të Dërguarit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem).

Ne e dimë se nga kushtet e avdesit është edhe nijeti (**qëllimi**), por me të mund të jetë për qëllim vepra, dispozitat e së cilës studiohen në fushën e Fikhut (**jurisprudencës**), por mund të jetë për

qëllim edhe ai për të cilin e kryen atë vepër, kështu që ne duhet të jemi të vëmendshëm për këtë çështje të madhe; d.m.th: kur të kryejmë ndonjë adhurim, të çojmë në mendje se ne jemi duke zbatuar Urdhërin e Allahut , me të cilën gjë vërtetohet sinqeriteti, dhe të çojmë në mendje gjithashtu se këtë vepër e ka kryer edhe i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) dhe ne jemi ndjekës të tij, duke vërtetuar kështu pasimin e tij (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) dhe të shariatit të tij.

Kjo, sepse prej kushteve të vlefshmërisë së punëve është: **“Sinqeriteti”** dhe **“Pasimi”**. Me këto të dyja vërtetohet dëshmia se nuk të adhuruar tjetër përveç Allahut dhe se Muhamedi është i Dërguari i Allahut.

Tani të kthehemi te ajo që përmendëm në fillim për vlerat e dijes, pasi që me dijen, njeriu adhuron Zotin e tij me dije të sigurt. Zemra e tij lidhet me adhurimin dhe ndriçohet me të, kur ai i vepron ato me idenë se ato janë adhurim dhe jo zakon. Vetëm kështu, nëse njeriu e kryen faljen në

këtë mënyrë, atëherë ai e ka të siguar atë për të cilën ka njoftuar Allahu, se namazi të ndalon nga e vepra e ulët dhe e keqe.

Nga vlerat dhe dobitë më të rëndësishme të dijës përmendim:

01 - Dija është trashëgimia e lënë nga Pejgamberët, të cilët nuk kanë lënë trashëgimi ar apo argjend, por kanë lënë dijen. Ndaj kush merr nga ajo, ai ka fituar pasuri të madhe nga trashëgimia e Pejgamberëve. Ti që jeton sot në shekullin e pesëmbëdhjetë të hixhretit, nëse merr nga dituria, ti ke trashëguar Muhamedin (sal-Allahu 'alejhi ue sel-lem) dhe kjo është nga vlerat më të mëdha të dijës.

02 - Dija mbetet ndërsa pasuria zhduket. Ja Ebu Hurejra (radijAll-llahu anhu), ka qenë prej sahabëve të varfër, aq sa rrëzohej nga uria si atij që i bien të fikët. Ju pyes për Allahun, a përmendet kujtimi i Ebu Hurejrës në mësin e njerëzve, në kohën tonë, apo jo? Sigurisht që po, shumë. Dhe Ebu Hurejra ka sevape njësoj si ai i cili përfiton nga hadithet e transmetuara nga ai,

pasi që dija mbetet, ndërsa pasuria zhduket. Kështu që, o ti kërkues i dijes, kapu fort në dije, sepse në një hadith nga i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sellem) është transmetuar se ai ka thënë: **“Kur njeriu vdes, atij i ndërpriten të gjitha punët, përveç tre gjërave: lëmosha e vazhdueshme (vakefi), dija me të cilën njerëzit përfitojnë dhe fëmija i mirë që bën lutje për të.”** [E transmeton Muslimi.]

03 - Poseduesi i dijes nuk mundohet për ta ruajtur atë, pasi që kur Allahu të furnizon me dije, vendi i saj është zemra dhe nuk ka nevojë për kasafortë e çelës. Ajo ruhet në zemër dhe në shpirt, dhe në të njëjtën kohë ajo është vetë ruajtësja jote, sepse ajo (**dija**) të ruan nga rreziku, me Lejen e Allahut të Madhëruar. Pra, dija të ruan ty, ndërsa pasurinë duhet ta ruash ti duke e futur në kasaforta të mbyllura me çelësa dhe megjithatë, përsëri nuk je i qetë për sigurinë e saj.

04 - Me dije, njeriu arrin të jetë prej dëshmuesve me të vërtetën. Argument për këtë është Fjala e Allahut të Lartësuar:

“Allahu dëshmon se nuk ka të adhuruar tjetër (me të drejtë) përveç Atij, edhe engjëjt, edhe ata të cilët posedojnë dije (dëshmojnë gjithashtu). Ai e mban krijimin e Tij në drejtësi të plotë.” [Al Imran: 18]

A mos ka thënë gjë: “Ata që posedojnë pasuri?” – “Jo”, por tha: “dhe ata të cilët posedojnë dije.”

Ndaj të mjafton ty, o kërkues i dijes, që të jesh prej atyre që dëshmojnë për Allahun se nuk ka të adhuruar tjetër përveç Tij, bashkë me engjëjt të cilët dëshmojnë për Njësimin e Allahut të Lartëmadhëruar.

05 - Dijetarët janë njëri prej dy llojeve të përgjegjësve të çështjeve të muslimanëve, për të cilët Allahu ka urdhëruar që t'u bindesh atyre, në Fjalën e Tij: **“O ju që keni besuar! Bindjuni Allahut, bindjuni të Dërguarit të Tij dhe atyre të cilët janë përgjegjës të çështjeve tuaja!”** [En Nisa: 59] Fjala **“përgjegjës”** në këtë ajet, përfshin përgjegjësit e muslimanëve prej prijësve e pushtetarëve dhe dijetarëve e nxënësve të

dijes. Përgjegjësia e dijetarëve është në sqarimin e Sheriatit të Allahut dhe në thirrjen e njerëzve tek Ai, ndërsa përgjegjësia e pushtetarëve është në zbatimin e Sheriatit të Allahut dhe detyrimin e njerëzve për këtë.

06 - Poseduesit e dijes janë ata të cilët ngrihen me Çështjen e Allahut të Madhëruar deri sa të bëhet Kijameti. Për këtë argumentohemi me hadithin e transmetuar nga Muavija (radijAll-llahu anhu) i cili ka thënë: Kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) të thotë: **“Atij të cilit Allahu i do të mirën, Ai i jep atij kuptim në Fe. Në të vërtetë, unë jam ndarës, ndërsa Allahu është Ai që jep. Dhe ky popull do të vazhdojë të qëndrojë i ngritur me Çështjen e Allahut, dhe nuk do të mund t’i dëmtojnë ata kundërshtarët e tyre, deri sa të vijë Urdhëri i Allahut (Kijameti).”** [E transmeton Buhariu.]

Ndërsa imam Ahmedi, për këtë grup ka thënë: “Nëse ata nuk janë dijetarët e hadithit, atëherë nuk e di se kush janë.”

Ndërsa Gjykatësi El Ijad (RahimehUllah), ka

thënë: “Ahmedi ka pasur për qëllim pasuesit e Sunetit dhe ata që besojnë ashtu si medh’hebi (besimi) i dijetarëve të hadithit.”

07 - I Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) nuk ka nxitur ndokënd për të pasur zili ndokënd tjetër për ndonjë mirësi që i ka dhuruar Allahu, veçse për dy mirësi:

- Kërkimi i dijes dhe të punuarit me të.

- Tregtari i cili e jep pasurinë e tij në shërbim të Islamit.

Transmetohet nga Abdullah ibën Mesudi (radijAll-llahu anhu) se ka thënë: i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: **“Nuk ka zili (të lejuar) veçse në dy gjëra: një burrë të cilit Allahu i ka dhënë pasuri dhe ai e shpezon atë në hak, dhe një burrë të cilit Allahu i ka dhënë urtësi (dije) dhe ai gjykon me të dhe ua mëson atë të tjerëve.”** [E transmeton Buhariu.]

08 - Ajo që ka ardhur në hadithin e transmetuar nga Ebu Musa el Eshari (radijAll-llahu anhu) se i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: **“Shembulli i asaj me të cilën më ka**

dërguar Allahu prej udhëzimit dhe dijes është si shembulli i shiut të begatë i cili bie në tokë, një pjesë e së cilës është e mirë, e pranon ujin dhe në të mbin kullota dhe bar i shumtë. Në të ka edhe pëllgje të cilat e mbajnë ujin dhe ajo u bën dobi njerëzve të cilët pijnë nga ajo, u japin të pinë kafshëve dhe vadisin të mbjellat. Ndërsa një pjesë tjetër toke është e shterpë, as nuk e mban ujin dhe as nuk mbin bar në të. Kështu është edhe shembulli i atij që e ka kapitur dhe ka dije në Fenë e Allahut dhe të cilit i ka bërë dobi ajo me të cilën më ka dërguar Allahu mua, ai mësoi dhe ua mësoi të tjerëve, dhe shembulli i atij i cili nuk ka ngritur kokë me këtë dhe nuk e ka pranuar udhëzimin e Allahut me të cilin unë jam dërguar.” [E transmeton Buhariu dhe Muslimi.]

09 - Dija është rruga për në xhenet, siç argumenton për këtë hadithi i transmetuar nga Ebu Hurejra (radijAll-llahu anhu) se i Dërguari i Allahut (sal- lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: **“Kushdo që ndjek një**

rrugë për të kërkuar dijen, Allahu i lehtëson me këtë gjë një rrugë për në xhenet.” [E transmeton Muslimi.]

10 - Ajo që transmetohet në hadithin e Muavijes (radijAll-llahu anhu) i cili thotë: I Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sellem) ka thënë: **“Atij të cilit Allahu i do të mirën, Ai i jep atij kuptim në Fe.”** D.m.th: e bën atë të ditur në Fenë e Allahut dhe perceptues të saj. Të kuptuarit e Fesë nuk është thjesht të njohurit e dispozitave të fikhut, të cilat janë të posaçme vetëm me shkencën e Fikhut, por me këtë është për qëllim dija e Teuhidit, bazave të Fesë dhe gjithçkaje që lidhet me Sheriatin e Allahut të Madhëruar. Dhe sikur të mos kishte tekste të tjera nga Kurani dhe Suneti përveç këtij hadithi për vlerën e dijes, ai do të ishte mëse i plotë për nxitjen për kërkimin e dijes së Sheriatitdhe Fikhut.

11 - Dija është dritë me të cilën robi ndriçohet dhe mëson si të adhurojë Zotin e tij dhe si të sillet me robët e Zotit të tij. Kështu që, rruga e tij me këtë është mbi dije dhe siguri.

12 - Dijetari është dritë me të cilën ndriçohen njerëzit në çështjet e fesë dhe të dynjasë së tyre. Që të gjithë ne e njohim historinë e atij burrit nga Beni Israilët, i cili vrau nëntëdhjetë vetë, pastaj pyeti për njeriun më të ditur në tokë dhe e adresuan te një burrë adhurues. Ky e pyeti nëse kishte pendim për të apo jo, ndërsa ai e zmadhoi shumë këtë çështje dhe i tha: **“Jo.” “Ky e vrau dhe i plotësoi me të njëqind të vrarë. Pastaj shkoi te një dijetar dhe e pyeti për çështjen e tij, ndërsa ai i tregoi se për të kishte pendim dhe se asgjë nuk mund të ndante mes tij dhe pendimit. Pastaj e adresoi atë për në një vend, banorët e të cilit ishin vepërmirë. Ky u nis për atje, por në rrugë i erdhi vdekja...”** Historia e tij është e njohur [E transmeton Buhariu.], por qëllimi është që të vërehet dallimi mes dijetarit dhe injorantit.

13 - Allahu i ngre dijetarët në botën tjetër dhe në këtë botë. Në botën tjetër, Allahu i ngre ata në grada sipas punës që kanë bërë prej thirrjes në Fenë e Allahut dhe të

punuarit me atë që mësuan, ndërsa në dynja, Allahu i ngre ata në mesin e robëve të Tij sipas punës së tyre. Allahu i Madhëruar thotë: **“...që Allahu t’i lartësojë ata të cilët besojnë dhe ata të cilëve u është dhënë dija në grada të larta.”** [el Muaxhadele: 11]

03. Gjykimi për kërkimin e dijes:

Kërkimi i dijes fetare është Farz Kifaje – obligim i përgjithshëm; nëse ngrihet me të një numër i mjaftueshëm njerëzish, atëherë për të tjerët ai është sunet. Kërkimi i dijes mund të jetë edhe Farz Ajn – obligim i posaçëm për një person të caktuar, dhe kjo dallohet nëse kryerja e një adhurimi apo veprë të caktuar të cilën dikush kërkon ta kryejë, qëndron në të mësuarit e saj, në këtë rast ai e ka obligim që të mësojë se si ta adhurojë Allahun e Madhëruar me atë adhurim apo me atë vepër.

Ndërsa përveç këtij rasti, dija është Farz Kifaje dhe kërkuesi i dijes duhet ta ndjejë se ai po ngrihet me kryerjen e një Farzi Kifai,

me qëllim që ai të arrijë njësoj si shpërblimi i vepruesit të asaj dijeje pas njohjes respective të saj.

Nuk ka dyshim se kërkimi i dijes është prej punëve më të mira, madje ai është prej Xhihadit në Rrugën e Allahut, sidomos në kohën tonë, në kohën kur ka filluar të shfaqen bidatet në shoqërinë muslimane, dhe të shtohen e të përhapen. Po kështu është shfaqur injorancë e madhe tek ata të cilët ndërmarrin dhënien e opinionëve **(fetvave)** pa dije dhe në mesin e njerëzve ka filluar polemikë e madhe.

Këto tre çështje e bëjnë mëse prerë që të rinjtë të kujdesen për kërkimin e dijes:

E para: Sherri i bidateve që ka filluar të shfaqet.

E dyta: Njerëz të cilët ndërmarrin dhënien e fetvave pa pasur dije.

E treta: Polemika e shumë njerëzve në çështje të cilat janë të qarta për dijetarët, por për to polemizojnë ata të cilët nuk kanë dije.

Për këtë shkak, ne kemi nevojë të domosdoshme për posedues të dije të cilët kanë dije të sigurt dhe horizont të gjerë, të cilët kanë dije dhe perceptim në Fenë e Allahut dhe të cilët kanë urtësi në udhëzimin e robëve të Allahut, pasi që shumë njerëz sot, arrijnë të përvetësojnë dije nga ana teorike për ndonjë çështje të caktuar, por atyre nuk u intereson të vështruarit në rregullimin e njerëzve dhe në edukimin e tyre. Madje nëse ata japin fetva, kështu e ashtu, kjo do të ishte rrugë e një të keqeje të madhe, përmasat e së cilës nuk i di veçse Allahu i Madhëruar.

Kapitulli i dytë.

Edukata e nxenesit te dijes dhe shkaqet ndihmuese per marrjen e dijes.

01. Edukata e nxënësit të dijes:

Nxënësi i dijes duhet patjetër që të mvishet me disa morale dhe edukata, prej të cilave po përmendim:

01.Pastrimi i qëllimit vetëm për Hir të Allahut të Madhëruar:

D.m.th. qëllimi i tij me kërkimin e dijes të jetë për Hir të Allahut dhe për të fituar botën tjetër, sepse Allahu i Madhëruar ka nxitur për këtë dhe ka përgëzuar për të, siç ka thënë Allahut i Madhëruar: **“Dije se nuk ka të adhuruar tjetër (me të drejtë) përveç Allahut dhe kërko falje për gjynahet e tua!”** [Muhamed, 19]

Po kështu lavdërimi i dijetarëve në Kuran është mëse i njohur, dhe kur Allahu lavdëron diçka apo urdhëron për të, ajo gjë bëhet adhurim.

Kështu që është i domosdoshëm pastrimi i qëllimit vetëm për Hir të Allahut në këtë adhurim (në kërkimin e dijes), d.m.th. që njeriu të ketë për qëllim Fytyrën e Allahut të Madhëruar me kërkimin e dijes.

Dhe nëse dikush bën nijet që me kërkimin e dijes fetare të arrijë marrjen e diplomës apo të ndonjë grade apo pozite, ta dijë se i Dërguari i Allahut (sal- lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: **“Kushdo që kërkon një dije me të cilën duhet pasur për qëllim Fytyra e Allahut të Madhëruar, dhe ky nuk e mëson veçse për të fituar diçka prej dynjasë, nuk ka për ta ndjerë aromën e xhenetit në ditën e kiametit.”** [E ka nxjerrë Imam Ahmedi (2/338), Ebu Daudi, Ibën Maxheh, El Hakim në Mustedrak (1/160), Ibën Ebi Shejbeh në **“El Musanef.”** El Hakim ka thënë: **“Ky hadith është i saktë dhe zinxhiri i transmetuesve të tij janë të besueshëm.”**]

Pra, ky është një kërcënim i ashpër...

Por nëse nxënësi i dijes thotë: “Unë kërkoj të marr diplomë jo për ndonjë fitim nga dynjaja, por sepse peshorja matëse e dijetarit sot është bërë diploma e tij.”

Atëherë themi: Në qoftë se me marrjen e diplomës është për qëllim bërja dobi njerëzve, për t’i mësuar apo drejtuar ata, e gjëra të ngjashme, ky është nijet i pastër dhe nuk e dëmton gjë, pasi që është nijet i drejtë.

Por ne e përmendëm qëllimin e pastër në krye të edukatave të nxënësit të dijes, pasi që ai është baza. Nxënësi i dijes duhet që me kërkimin e dijes të ketë për qëllim zbatimin e urdhrit të Allahut të Madhëruar, sepse Allahu ka urdhëruar për kërkimin e dijes dhe ka thënë: **“Dije se nuk ka të adhuruar tjetër (me të drejtë) përveç Allahut dhe kërko falje për gjynahet e tua!”** [Muhamed, 19]

Pra, ka urdhëruar për kërkimin e dijes, dhe nëse ti mëson dhe kërkon dije, ke zbatuar Urdhrin e Allahut të Madhëruar.

02. Ngritja e injorancës nga vetja dhe nga të tjerët:

D.m.th. që me kërkimin e dijes duhet të kesh për qëllim ngritjen e injorancës nga vetja dhe nga të tjerët, pasi që origjina tek njeriu është injoranca dhe padituria, argument për të cilën është Fjala e Allahut: **“Dhe Allahu ju ka nxjerrë nga mitrat e nënave tuaja duke mos ditur (ju) asgjë. Ai ju dha edhe dëgjimin, shikimin dhe zemrën që të mund të falënderoni (Atë).”** [En Nahl, 78]

Aktualiteti dëshmon gjithashtu për këtë gjë, pasi që ti me kërkimin e dijes synon ngritjen e injorancës nga vetja dhe kështu arrin frikërespektin ndaj

Allahut: “Vërtet ata që i frikësohen më shumë Allahut nga robët e Tij, janë dijetarët.” [Fatir, 28]

Pra, ti duhet të synosh ngritjen e injorancës nga vetja jote, pasi që origjina tek ti është mosdija. E nëse mëson dhe bëhesh prej dijetarëve, atëherë injoranca ngrihet nga ti.

Po kështu duhet të kesh qëllim edhe ngritjen e injorancës nga ymeti musliman, gjë e cila bëhet duke dhënë mësim me mënyrat nga më të ndryshmet, me qëllim që t'u bësh dobi njerëzve me dijen tënde.

A është kusht për bërjen dobi me dijen, që të ulesh nëpër tubime në xhami, apo mund t'i bësh dobi njerëzve në çdo rast dhe vend?

Përgjigja: E sakta është e dyta, sepse Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel- lem) ka thënë: **“Publikoni prej meje goftë edhe një ajet.”** [E ka nxjerrë Buhariu (Kitabul Enbija).]

Sikur ti të mësosh një njeri dhe ai të mësojë një tjetër, ty të shkruhet shpërblimi i dy njerëzve. Nëse ky mëson një të tretë, ty të shkruhet shpërblimi i tre njerëzve, e kështu. Por është prej bidatit që kur një njeri bën një adhurim të thotë: **“O Zot! Sevapin e këtij adhurimi bëje për të Dërguarin e Allahut!”**, sepse Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) është ai që ta ka mësuar dhe të ka drejtuar tek ajo, kështu që atij i

shkruhet njësoj si shpërblimi yt.

Imam Ahmedi (RahimehUllah) thotë: “Asgjë nuk mund të barazohet me dijen, tek ai njeri që ka nijetin e pastër.” – Thanë: “E si kështu?” - Ai tha: “Duke bërë nijet ngritjen e injorancës nga vetja dhe nga të tjerët” sepse origjina tek njerëzit është injoranca ashtu si edhe tek ti, dhe nëse mëson me qëllim që të ngresh injorancën nga ky popull, ti je prej muxhahidëve në Rrugën e Allahut të Madhëruar, të cilët përhapin Fenë e Allahut.

03. Mbrojtja e shariatit:

D.m.th. të bësh nijet që me kërkimin e dijes të mbrosh shariatin, sepse librat nuk mund t'a mbrojnë shariatin, por ata që e mbrojnë atë janë mbartësit e shariatit.

Sikur dikush prej bidatçinjve të hynte në një librari të mbushur plot me libra të shariatit, dhe ky fillon të flasë me ndonjë bidat të cilin e pohon, nuk besoj se qoftë edhe një libër i vetëm t'ja kthejë atij dhe ta kundërshtojë atë. Por sikur të fliste me bidatin e tij para ndonjë njeriu të ditur me

qëllim që ta pohojë dhe vërtetojë atë, atëherë ky kërkues i dijes ia kthen atij dhe e rrëzon fjalën e tij me Kuran dhe Sunet.

Pra, nxënësi i dijes duhet që me kërkimin e dijes të synojë edhe mbrojtjen e sheriatit, pasi që mbrojtja e sheriatit nuk mund të bëhet veçse me burrat e tij, tamam si arma; sikur ne të kishim depot ë mbushura plot me armë, a ndodh që këto armë të ngrihen vetë dhe të hedhin predha mbi armikun? A nuk bëhet kjo veçse me burra?

- Përgjigja është se kjo nuk bëhet veçse me burra. Po kështu është edhe dija.

Përveç kësaj, bidatet përtërihen. Mund të ekzistojnë bidate që nuk kanë pas ekzistuar në kohët e para dhe nuk gjenden nëpër libra, kështu që sheriatin në këtë rast nuk mund ta mbrojë veçse nxënësi i dijes.

Ndaj them: Ajo që nxënësi i dijes duhet të ketë parasysh është mbrojtja e sheriatit, pasi që njerëzit kanë shumë nevojë për dijetarët, me qëllim që t'i kthejnë mbrapsht intrigat e bidatçinjve dhe të gjithë armiqtë të Allahut. Por kjo nuk mund të bëhet veçse

me dije fetare të përfituar nga Libri i Allahut dhe nga Suneti i Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem).

04. Zemërgjerësia në çështjet ku nuk ka pajtim:

D.m.th. që nxënësi i dijes duhet ta ketë zemrën të gjerë në lidhje me çështjet ku ka mospajtim dhe shkak i të cilave është ixhtihadi (**përpyekja me argumente**); pasi që çështjet ku ka mospajtim mes dijetarëve janë dy llojesh: ose çështje të cilat nuk pranojnë përpyekje argumentuese por janë të qarta dhe të prera, në këto çështje nuk ka justifikim për kundërshtuesin e tyre, ose çështje të cilat pranojnë përpyekje argumentuese dhe në këto çështje justifikohet kundërshtuesi i tyre, dhe fjala jote nuk mund të jetë argument kundër kundërshtuesit tënd në to, pasi që sikur të ishte ashtu, atëherë mund të thuhej edhe e kundërta: që fjala e tij është argument kundër teje.

Ndërsa unë kam për qëllim këtu ato çështje të cilat pranojnë arsyetim dhe argumentim me logjikë dhe argumente, dhe në të cilat njeriut i lejohet të diskutojë, por ama kush kundërshton rrugën e selefëve siç janë çështjet e akides, çështje të cilat nuk pranohet nga askush që të kundërshtojë kuptimin e selefëve në to.

Pra, është qëllimi për çështjet e tjera në të cilat ka vend për ixhtihad; nuk duhet që nga ky mospajtim në këto çështje të merret shkas për sharjen e të tjerëve dhe as shkas për armiqësi e urrejtje.

Sahabet (radij-Allahu ‘anhum) janë kundërshtuar në çështje të shumta, dhe kush dëshiron të njohë mospajtimet mes tyre, të kthehet tek gjurmët e përcjella prej tyre dhe ka për të gjetur mospajtim në shumë çështje, të cilat kanë qenë shumë më të mëdha se ato çështje të cilat njerëzit sot i marrin shkas për mosmarrëveshje, sa që janë ndarë në parti dhe thonë: **“Unë jam me filanin dhe unë me alanin”**, sikur të ishte çështje partishë. Kjo padyshim që është gabim.

Për shembull, sikur dikush t'i thotë shokut: “Kur të ngrihesh nga rukuja mos e vendos dorën e djathtë mbi të majtën (mbi gjoks) por lëshoi duart anash kofshëve. Nëse nuk vepron kështu, ti je bidatçi.”

Fjala **“bidtaçi”** nuk është e lehtë për shpirtin, dhe nëse dikush ma thotë mua këtë, në zemrën time do të lindë diçka prej urrejtjes; sepse kështu është njeriu.

Në këtë çështjen e duarve ne themi se ka vend për mospajtim, kështu që ose vendosi duart mbi njëra tjetrën ose lëshoi **(pas rukusë)**.

Për këtë, Imam Ahmedi ka thënë se njeriu ka të drejtë të zgjedhë vendosjen e dorës së djathtë mbi të majtën ose t'i lëshojë; sepse çështja këtu është e gjerë dhe e hapur.

Por cili është suneti në analizimin e kësaj çështje?

Përgjigja: Suneti në këtë çështje është që të vendosësh dorën e djathtë mbi të majtën kur të ngrihesh nga rukuja, njësoj si i vendos kur qëndron në këmbë.

Argument për këtë është hadithi i nxjerrë nga Buhariu, ku thuhet se Sehl ibën Sead ka thënë: **“Njerëzit urdhëroheshin që burri të vendoste dorën e tij të djathtë mbi parakrahun e të majtës, në namaz.”** [E ka nxjerrë Buhariu (Kitabu Sifatu es salat).]

Të shohim: A është për qëllim këtu kur ishin në sexhde? Apo kur ishin në ruku apo kur uleshin?

Jo, por ka qëllim kur ishin në këmbë, dhe kjo përfshin qëndrimin në këmbë para rënies në ruku dhe pas ngritjes nga rukuja.

Por nga mospajtim mes dijetarëve ne nuk duhet të marrim shkas për grindje dhe përçarje, sepse që të gjithë ne kërkojmë hakun dhe secili ka vepruar atë përfundim që ka arritur me ixhtihadin e tij. Përderisa është kështu, atëherë nuk lejohet që prej kësaj të marrim shkas për armiqësi dhe përçarje mes dijetarëve, sepse dijetarët do të vazhdojnë të kenë mendime të ndryshme nga njëri-tjetri, madje që në kohën e Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem).

Pra, obligimi i nxënësve të dijes është që të jenë një dorë e vetme dhe nga ky mospajtim të mos marrin shkas për largim nga njëri-tjetri dhe urrejtje të njëri-tjetrit, por obligimi në rastin kur e kundërshton shokun tënd bazuar në argumentin që këdo he ai të kundërshton ty me argumentin e tij, obligimi në këtë rast është që ta vendosni veten tuaj në të njëjtën rrugë dhe dashuria mes jush të shtohet.

Ndaj ne i duam dhe i përgëzojmë të rinjtë tanë të cilët tashmë kanë drejtim të fortë në vendosjen e çështjeve përballë argumenteve dhe në ndërtimin e dijes së tyre sipas Librit të Allahut dhe sunetit të Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem). Mendojmë se kjo është diçka e hajrit dhe se kjo na përgëzon me hapjen e dymëve të dijes nga rrugët e sakta të saj, dhe nuk duam që ata ta marrin këtë gjë shkas për ndarje në parti dhe urrejtje mes tyre, ndërsa Allahu i ka thënë Pejgamberit të Tij (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): **“Vërtet ata që e ndajnë fenë e tyre dhe shpërndahen në sekte e grupe ti (O Muhammed) nuk ke aspak të bësh me ta.**

Puna e tyre është vetëm me Allahun i Cili paskësaj do t'u tregojë atyre çfarë ata vepronin.” [El Enam, 159]

Ata të cilët e fusin veten e tyre në parti dhe bëhen partiakë **(të njëanshëm)**, ne nuk i aprovojmë ata në këtë gjë sepse partia e Allahut është vetëm një parti, dhe mendojmë se mospajtimi në kuptim nuk duhet të ketë rezultat largimin e njerëzve nga njëri-tjetri dhe as shkeljen e të drejtave të vëllait tënd.

Prandaj, është detyrë e nxënësve të dijes që të jenë vëllezër, edhe nëse nuk pajtohen në disa çështje dytësore, dhe secili prej tyre ta thërrasë tjetrin me qetësi dhe dialog nga i cili kërkohet Fytyra e Allahut dhe arritja tek dija. Kështu arrihet harmonia dhe hiqet ky ankth dhe dhunë që ekziston tek disa njerëz, të cilët arrijnë deri atje sa që grinden dhe bëhen armiq të njëri-tjetrit, gjë e cila padyshim që i gëzon armiqtë e muslimanëve.

Grindja mes ymetit musliman padyshim që është e keqja më e madhe që ekziston në

dëm të tij. Allahu i Madhëruar thotë: “Bindjuni edhe Allahut edhe të Dërguarit të Tij, mos u kundërshtoni (me njëri-tjetrin) që të mos humbni kurajon dhe të mos ju lënë fuqitë dhe jini të duruar e të qetë.

Vërtet që Allahu është me të duruarit.”
[El Enfal, 46]

Edhe sahabet (radij-Allahu ‘anhum) kishin mospajtim për çështje të tilla, por megjithatë ata ishin në një zemër, në dashuri dhe harmoni me njëri-tjetrin.

Madje unë iu them qartë se në të vërtetë ai i cili të kundërshton ty i bazuar në argumentin që ka, ai në fakt është pajtuar me ty; pasi që secili nga ju dy kërkon të vërtetën dhe si rrjedhojë qëllimi është një: njohja e të vërtetës me argument. Pra ai nuk të ka kundërshtuar ty përderisa ti e pohon se ai të kundërshtuar për shkak të argumentit që ka. Atëherë ku është kundërshtimi këtu?

Nëse ecet sipas kësaj rruge, ymeti musliman mbet një ymet i vetëm, edhe pse nuk pajtohen në disa çështje për shkak të

argumentit që ka secili.

Por, ai që bën kokëfortësi dhe mendjemadhësi pas shfaqjes dhe qartësimit të së vërtetës, padyshim se me të duhet sjellë ashtu si e meriton, pas kokëfortësisë dhe kundërshtimit të tij. Pra, sipas vendit **(rastit dhe personit)** thuhet fjala **(jepet gjykimi)**.

05. Të punuarit me dijen:

D.m.th. që nxënësi i dijes duhet të punojë me dijen e tij në akide dhe në adhurime, në morale, sjellje dhe marrëdhënie me njerëzit, sepse këto janë frytet e dijes dhe rezultatet e saj. Mbartësi i dijes është si mbartësi i armës; ose me të ose kundër tij. Ndaj ka ardhur në hadith se Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë: **“Kurani është argument për ty ose kundër teje.”** [E ka nxjerrë Muslimi (Kapitulli i Abdesit).]

D.m.th. Kurani është argument për ty nëse punon me të, dhe kundër teje nëse nuk punon me të.

Po kështu duhet punuar sipas asaj që është përcjellë nga Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem); që t’i besosh njoftimet e tij dhe të zbatosh dispozitat.

Kur të vjen një lajm nga Allahu dhe i Dërguari i Tij, besoje atë dhe pranoje me dëshirë dhe dorëzim, dhe mos thuaj: Përse? Si? Sepse kjo është rruga e mosbesimtarëve. Allahu i Madhëruar thotë: **“Kur Allahu dhe i Dërguari i Tij kanë vendosur për një çështje, nuk i takon asnjë besimtari dhe asnjë besimtareje që në vendimin e tyre të bëjnë ndonjë zgjidhje tjetër. Dhe kushdo që nuk i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij, padyshim që ka humbur në gabim të qartë.”** [El ahzab, 36]

Edhe sahabëve ndodhte që Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) t’u thoshte gjëra të cilat ishin të panjohura dhe larg perceptimit të tyre, por megjithatë ata i prisnin ato me pranim dhe nuk thoshin: Përse? Si?

Ndryshe nga këta njerëzit e fundit të këtij ymeti, ku gjejmë që kur dikujt prej tyre i

tregohet një hadith nga hadithet e Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), për të cilin mendja e tij bëhet konfuze **(dyshon)**, e gjejmë atë të sjellë komentime e gjëra të paqëna, të cilat zbulojnë se ai kërkon të kundërshtojë dhe jo të udhëzohet, ndaj edhe vendoset pritë mes tij dhe suksesit, deri sa ta kundërshtojë atë që ka ardhur nga Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), sepse ai nuk e priti atë me pranim dhe dorëzim.

Për këtë po sjell një shembull: Është përcjellë nga Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) se ai ka thënë: “Zoti ynë zbret në qiellin e kësaj dynjaje kur ka mbetur edhe një e treta e fundit e natës, dhe thotë: Kush është ai që më lutet Mua, që t’i përgjigjem lutjes së tij? Kush është ai që më kërkon Mua, që t’i jap atij? Kush është ai që më kërkon falje Mua, që Unë t’ja fal atij?” [E ka nxjerrë Buhariu (Kitabu et Tehexhud) dhe Muslimi (Kitabu Salatu el Musafirin).]

Këtë hadith e ka thënë Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) dhe ai është hadith **“Meshhur” (i njohur, i përhapur)**

madje është hadith **“Mutevatir”** (i përcjellë nga grup i madh transmetuesish), dhe askush nga sahabet nuk e ka ngritur gjuhën e tij dhe të thotë: “O i Dërguari i Allahut! Si zbret?” “A mbet Arshi bosh kur Ai zbret apo jo?” **Si dhe pyetje të ngjashme me këto.**

Ndërsa sot gjejmë njerëz të thonë gjëra të tilla: Si mund të vazhdojë të jetë mbi Arsh kur zbret në qiellin e dynjasë? Si dhe fjalë të tjera kundërshtuese që sjellin.

Por nëse ata do ta pritnin me pranim këtë hadith dhe të thoshin se Allahu i Madhëruar qëndron mbi Arshin e Tij dhe lartësia është prej domosdoshmërisë së Vetes së Tij, dhe se Ai zbret ashtu si dëshiron –i Madhëruari-, atëherë do t'i hiqeshin këto dyshime dhe nuk do të bëheshin konfuzë në lajmin e sjellë nga Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), nga Zoti i tij.

Pra, detyra jonë është që ta presim me pranim dhe dorëzim atë që ka njoftuar Allahu dhe i Dërguari i Tij nga çështjet e

fshehta, dhe të mos e kundërshtojmë atë me mendjet tona dhe perceptimet që kemi në lidhje me gjërat materiale dhe të dukshme, sepse e fshehta është diçka mbi këtë, dhe shembujt për këtë gjë janë të shumta, nuk desha t'a zgjas me përmendjen e tyre.

Por qëndrimi i muslimanit në lidhje me hadithe të tilla është që t'i pranojë dhe të dorëzohet para tyre; të thotë se Allahu dhe Pejgamberi i Tij kanë thënë të vërtetën, ashtu si ka njoftuar Allahu në Fjalën e Tij: **“I Dërguari (Muhammedi) beson në çfarë i është zbritur atij nga Zoti i tij dhe po kështu edhe besimtarët (besojnë bashkë me të).”** [El Bekare, 285]

Akidja (**bindja**) duhet të jetë e ndërtuar sipas Librit të Allahut dhe sunetit të Pejgamberit të Tij (sal-lAllahu ‘alejhi ue sellem), dhe njeriu duhet ta dijë se logjika e tij nuk ka vend në të (**që ta kundërshtojë apo të shtojë**).

Them se për logjikën nuk ka vend në të, për shkak se për tekstet qiellore të ardhura për përsosmërinë e Allahut logjika është

dëshmuese edhe pse nuk i percepton në detaje ato që i përkasin Allahut në përsosmërinë e Tij, por ajo **(logjika njerëzore)** e percepton se Allahu ka të gjitha cilësitë e përsosura.

Pra, duhet që nxënësi i dijes të punojë me këtë dije të cilën Allahu ia ka dhuruar atij me Mirësinë e Tij, në çështjen e akides.

Po kështu edhe në çështjen e adhurimit të Allahut të Madhëruar, siç e dinë shumë prej nesh, adhurimi ndërtohet mbi dy çështje kryesore:

- 01 - Singëriteti për Hir të Allahut të Madhëruar.
- 02 - Pasimi i Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem).

Njeriu duhet ta ndërtojë adhurimin e tij sipas asaj që ka ardhur nga Allahu dhe i Dërguari i Tij (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), dhe të mos shpikë në fenë e Allahut diçka që nuk është prej saj; as në origjinën e adhurimit dhe as në cilësitë e tij, andaj ne themi: Adhurimi duhet të jetë i vërtetuar me shariat në formën e tij, vendin e tij, kohën e tij dhe shkakun e tij. Pra, adhurimi duhet të

jetë i vërtetuar me shariat në të gjitha këto.

Sikur dikush të sjellë diçka prej shkaqeve të një lloj adhurimi të caktuar për të adhuruar Allahun me të, pa pasur argument, atëherë ia kthejmë mbrapsht atij këtë gjë dhe i themi: Kjo është e papranueshme, sepse duhet patjetër që të vërtetohet se ky shkak është për këtë adhurim, përndryshe nuk pranohet.

Sikur dikush të bëjë të lejuar një lloj adhurimi i cili nuk ka ardhur në shariat, ose sjell diçka e cila ka ardhur në shariat por në një formë të shpikur nga ai, apo në një kohë të shpikur nga ai, këtij i themi se kjo gjë të kthehet mbrapsht, pasi që adhurimi duhet të jetë i ndërtuar sipas asaj që ka ardhur në shariat, sepse kjo është domethënia e asaj që Allahu të ka mësuar ty prej dijes, që të mos e adhurosh Allahun veçse me atë që Ai ka bërë të ligjshme.

Prandaj dijetarët thonë se origjina në adhurime është ndalimi deri sa të vijë argument për lejueshmërinë e tij, duke u argumentuar me Fjalën e Allahut: **“Apo**

kanë ata shokë e të barabartë me Allahun (zota të rremë të tyre) të cilët kanë themeluar e përcaktuar për ta ndonjë fe të cilën nuk e ka urdhëruar e përcaktuar Allahu?” [Esh Shura, 21]

Si dhe me fjalën e Pejgamberit (sal-lallahu ‘alejhi ue sel-lem), të ardhur në hadith të saktë nga Aisha (radiallahu anha): **“Kushdo që vepron diçka e cila nuk është sipas rrugës sonë, ajo është e refuzuar.”** [E ka nxjerrë Muslimi (Kitabul Ekdije).]

Edhe sikur të jesh i sinqertë dhe të kesh për qëllim afrimin tek Allahu dhe tek shpërblimi i Tij, por e bën këtë me rrugë jo të ligjëruar, kjo të kthehet mbrapsht. Edhe sikur ti të duash të arrishë tek Allahu me anë të një rruge të cilën Allahu nuk e ka bërë rrugë për të arritur tek Ai, kjo gjë të kthehet mbrapsht.

Kështu që obligimi i nxënësit të dije është që t’a adhurojë Allahun e Madhëruar me atë që ka mësuar nga sheriami, pa shtuar dhe pa hequr gjë prej ti. Të mos thotë se kjo gjë me të cilën desha të adhuroj Allahun

është diçka me të cilën më qetësohet zemra dhe më hapet gjoksi. Këtë gjë nuk duhet ta thuash kurrë, edhe sikur të ndodhë vërtetë ajo gjë, por ta peshojë atë me peshoren e sheriatit; nëse për atë vepër dëshmon Kurani dhe Suneti, e mirëpresim, përndryshe njeriut mund t'i zbukurohet vepra e tij e keqe: **“A është ai pra, të cilit e keqja e veprave të veta i duket sikur është e mirë, saqë ai e quan atë të mirë (njësoj me atë që është i udhëzuar drejt)? Vërtet që Allahu humb atë që Ai do dhe udhëzon atë që Ai do...”** [Fatir, 8]

Po kështu, duhet që nxënësi i dijes të punojë me dijen e tij në sjelljet dhe marrëdhëniet me njerëzit. Dija fetare fton në të gjitha moralet e larta të sinqeritetit, mbajtjes së fjalës, dëshirimit të së mirës për besimtarët, sa që Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: **“Askush prej jush nuk beson deri sa të dojë për vëllanë e tij atë që dëshiron për vete.”** [E ka nxjerrë Buhariu (Kitabul Iman) dhe Muslimi (Kitabul Iman).]

Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) gjithashtu ka thënë: “Kush dëshiron që të largohet prej zjarrit (të xhehenemit) dhe të hyjë në xhenet, le t’i vijë vdekja duke qenë se ai beson në Allahun dhe në botën tjetër, dhe të sillet me njerëzit ashtu si dëshiron të sillen me të.” [E ka nxjerrë Muslimi (Kitabul Imara).]

Shumë prej njerëzve kanë xhelozë dhe dashuri për të mirën, por nuk sillen mirë me njerëzit. I gjejmë ata të jenë të ashpër dhe të dhunshëm edhe në thirrjen në fenë e Allahut, gjë e cila është në kundërshtim me moralet që ka urdhëruar Allahu i Madhëruar.

Dije se morali i mirë është prej gjëravë që të afrojnë tek Allahu i Madhëruar dhe se njerëzit më të afërm tek Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) dhe më pranë tij në gradë janë ata që e kanë moralin më të mirë, siç ka thënë Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): **“Me të vërtetë, nga më të dashurit prej jush tek unë dhe më pranë meje në ditën e kiametit janë ata që kanë moralin më të mirë nga ju. Dhe**

me të vërtetë se më të urryerit prej jush tek unë dhe më larg meje në ditën e kiametit janë llafazanët, dënglamëshenjtë dhe mutefejkahunët.” – Thanë: O i Dërguari i Allahut! E dimë se cilët janë llafazanët dhe dënglamëshenjtë, po mutefejkahunët cilët janë? – **“Mendjemëshenjtë”** – tha ai (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem). [E ka nxjerrë Tirmidhiu (Kitabu el Biru ues sileh), Imam Ahmedi me tekst të përafërt, Begaviu në **“Sherhus Suneh”** dhe Hejthemi në **“Mexhma ez Zevaid”**, dhe ka thënë (ky i fundit): **“Këtë hadith e ka nxjerrë Ahmedi dhe Taberani, dhe transmetuesit e Ahmedit janë burra të hadithit të saktë.”**]

06. Thirrja në fenë e Allahut:

Nxënësi i dijes duhet të ftojë në fenë e Allahut me dijen e tij, në çdo rast të volitshëm, në xhami e në tubime, në tregje etj. Kur të Dërguarit të Allahut (sal- lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) i erdhi shpallja nga Allahu, ai nuk ndenji ulur në shtëpinë e tij,

por fonte njerëzit dhe lëvizte.

Unë nuk dua që nxënësi i dijes të jetë si një kopje libri, por dua që ai të jetë dijetar që vepron me dijen e tij.

07. Urtësia:

Nxënësi i dijes duhet të zbukurohet me urtësi, për të cilën Allahu i Madhëruar thotë: “Ai ia jep urtësinë kujt të dojë. Cilitdo që i është dhënë urtësia, vërtet që i është dhënë një mirësi e madhe.” [El Bekare, 269]

Urtësia është që nxënësi i dijes të jetë edukues i të tjerëve, në moralet që ai mvishet dhe në thirrjen e tij për tek Allahu duke i folur çdo njeriu sipas gjendjes së tij. N.q.s. ndjekim këtë rrugë, kemi për të arritur hajër të madh, ashtu si thotë Zoti ynë: **“Cilitdo që i është dhënë urtësia, vërtet që i është dhënë një mirësi e madhe.”** [El Bekare, 269]

I urti është ai i cili i vendos gjërat në vendin e tyre, pasi që fjala **“i urtë”** rrjedh nga **“urtësia”**, e cila është ekzaktësia, që d.m.th. vendosja e çdo gjëje në vendin e vet me përpikmëri. Kështu që duhet, madje

është detyrim që nxënësi i dijes të jetë i urtë në thirrjen e tij.

Ndërsa shkallët i thirrjes i ka përmendur Allahu në Fjalën e Tij: “Thirr në rrugën e Zotit tënd me mençuri dhe këshillë të bukur dhe diskuto me ata në mënyrën më të mirë! Me të vërtetë, Zoti yt i di më së miri ata që janë shmangur nga rruga e Tij, e di më së miri ata, që janë në rrugë të drejtë.” [En Nahl, 125]

Allahu ka përmendur edhe një shkallë të katërt të dijes në polemikën me ithtarët e Librave të mëparshëm, ku thotë: **“Diskutoni me ithtarët e Librit vetëm me mënyrën më të mirë, por jo me keqbërësit e tjerë.”** [El Ankebut, 46]

Pra, nxënësi i dijes duhet të zgjedhë mënyrën më të përshtatshme dhe më të pranuar të thirrjes, sipas rastit.

Si Shembull: për këtë nga thirrja e Pejgamberit tonë (sal-lAllahu ‘alejhi ue sellem) përmendim: “Një beduin erdhi dhe urinoi në një cep brenda xhamisë. Sahabet u ngritën me nxitim që ta ndalonin, por

Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) i ndaloi ata. Kur përfundoi së urinuari, Pejgamberi e thirri dhe i tha: “Në këto xhami nuk lejohen gjëra të tilla si urina dhe ndytësi, por ato janë për përmendjen e Allahut, për falje dhe leximin e Kuranit.” [Muslimi 285.]

A keni parë urtësi më të madhe se kjo?

Ai beduini u bind dhe u kënaq saqë tha: “O Zot! Më mëshiro vetëm mua dhe Muhamedin, dhe mos mëshiro askënd tjetër me ne!”

Ja edhe një histori tjetër e transmetuar nga Muavije ibën el Hakem es Sulemi, i cili thotë: “Ndërsa isha duke u falur me të Dërguarin e Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), një burrë teshtiu dhe unë i thashë: **“Jarhamukallah!”** (Allahu të mëshiroftë!). Të gjithë njerëzit hodhen sytë nga unë, ndërsa unë thashë: **“O nëne! Ç’keni që shikoni nga unë?”** Atëherë filluan të përplasnin duart mbi kofshët e tyre dhe kur pashë që donin të heshtja, heshta. Kur i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-

lem) e kreu faljen, për Zotin, nuk kam parë mësues më të mirë se ai. Pasha Allahun! As nuk më urrejti, as nuk më goditi dhe as nuk më shau, por tha: **“Në namaz nuk lejohet asgjë nga fjalët e njerëzve, por vetëm tesbih (lavdërim i Allahut), tekbir (madhërim i Allahut) dhe lexim i Kuranit.”** [Muslimi 537.]

Prej këtu shohim se thirrja tek Allahu duhet të jetë me urtësi, ashtu si ka urdhëruar Allahu i Madhëruar.

Një shembull tjetër: I dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) pa një burrë i cili kishte vendosur një unazë prej ari - e cila është e ndaluar për burrat

- dhe ia hoqi nga dora pastaj e flaku dhe tha: “A guxon ndokush prej jush që të marrë një copë thëngjill dhe ta vendosë në dorën e tij?” [Muslimi 2091.] Kur Pejgamberi u largua, dikush i tha atij burrit: “Merre unazën tënde dhe përfito prej saj.” Ai tha: “Pasha Allahun! Nuk e marr më atë unazë të cilën e flaku i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem).”

Shohim që mënyra e këshillës këtu është më e ashpër, pasi që sipas vendit bëhet kuvendi. Kështu duhet të veprojë çdokush që thërret në fenë e Allahut: t'i vendosë gjërat në vendin e tyre dhe të mos i fusë njerëzit të gjithë në një thes.

Qëllimi është që të arrihet përfitimi dhe dobia.

Nëse do të hidhnim një sy në gjendjen e shumë prej thirrësve sot, do të gjenim që disa prej tyre rrëmbehen nga xhelozia për fenë dhe i largojnë njerëzit nga thirrja e tyre. Nëse gjen dikë që vepron ndonjë vepër të ndaluar, ai e bën publike me të madhe dhe i thotë: **“A nuk e ke frikë Allahun!”** e shprehje të ngjashme me këtë, gjë e cila nuk është e mirë, sepse kjo do të pritët me të kundërtën e saj.

Shehu i Islamit, Ibën Tejmije ka përcjellë nga Imam Shafi'u mendimin e tij në lidhje me Ehlul Kelam, ku thotë: “Është thënë gjithashtu se Ehlul Kelam duhet të goditen me lëkurë palme dhe me këpucë, dhe të sillen rrotull nëpër rrugët e fiseve të

ndryshme. Dhe të thuhet: Ky është dënimi i atyre që lënë Kuranin dhe Sunetin, dhe shkojnë te filozofia.”

Shejhu i Islamit thotë: “Kur dikush vështron tek këta, sheh se e meritojnë atë që ka thënë Shafiu, por kur vështron me syrin e caktimit dhe të mëdyshjes që i ka zotëruar ata, si dhe faktin se shejtani i ka mundur ata, atëherë bëhesh i butë dhe i mëshiron ata, dhe falënderon Allahun që e ka shpëtuar nga ajo me të cilën i ka sprovuar ata. Atyre u është dhënë mençuri, por në fakt nuk është dhënë, u është dhënë të kuptuar por nuk u është dhënë dije, apo u është dhënë të dëgjuar, të shikuar dhe zemra, por atyre nuk u ka bërë dobi dëgjimi, shikimi dhe as zemrat e tyre.”

Kështu duhet të veprojmë, o vëllezër; të vështrojmë tek njerëzit që bëjnë gjynahe me dy vështrime: vështrimin e sheriatit dhe vështrimin e caktimit të Allahut.

Vështrimi i sheriatit: d.m.th. të mos na pengojë asgjë në zbatimin e ligjit të Allahut, siç ka thënë Allahu në lidhje me të

pandershmen dhe të pandershmin:
“Laviren dhe lavirin – ta rrihni çdonjërin prej tyre me nga njëqind goditje. Të mos ju pengojë kurrfarë mëshire për të kryer detyrën e fesë së Allahut...” [En Nur, 2]

Gjithashtu shohim tek ata me syrin e caktimit të Allahut dhe i mëshirojmë ata, bëhemi të butë me ta dhe sillemi me ta në mënyrën që e shohim më të mirë për arritjen e qëllimit dhe heqjen e së keqes.

Kjo është nga gjurmët e nxënësit të dijes, ndryshe nga i padituri, i cili ka xhelozin për fenë por nuk ka dije.

Pra, nxënësi i dijes, thirrësi në fenë e Allahut duhet të përdorë urtësinë.

08. Nxënësi i dijes duhet të jetë i duruar në mësim:

D.m.th. të vazhdojë me vendosmëri dhe pa ndërprerje në kërkimin e dijes aq sa të mundet. Të durojë me dijen dhe të mos mërzitet me të, sepse kështu ai arrin shpërblimin e durimtarëve nga njëra anë,

dhe përfundim të mirë nga ana tjetër. Dëgjo Fjalën e Allahut drejtuar Pejgamberit të Tij (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): **“Këto janë (disa) nga lajmet e fshehta që Ne t’i shpallim ty. Këto nuk i ke ditur as ti, as populli yt para kësaj (shpalljes së Kuranit). Andaj, duro! Se, vërtet, në fund, fitorja është e të devotshmëve.”** [Hud, 49]

09. Nderimi i dijetarëve dhe vlerësimi i tyre:

Nxënësit e dijes e kanë detyrim që t’i nderojnë dijetarët dhe t’i vlerësojnë ata. Ata duhet të zgjerojnë gjoksin në lidhje me kundërshtimet që ndodhin mes dijetarëve, dhe ta justifikojnë atë që ndjek mendimin e gabuar sipas tyre. Kjo është një pikë shumë e rëndësishme, pasi që disa njerëz ndjekin gabimet e të tjerëve me qëllim që të kapin prej tyre diçka që nuk u përshtatet dhe pastaj t’u prishin imazhin në mesin e njerëzve.

Kjo gjë është nga gabimet më të mëdha, dhe nëse përgojimi i njerëzve të thjeshtë

njëri-tjetrin është prej gjynaheve të mëdha, atëherë përgojimi i dijetarëve është gjynah shumë e shumë më i madh, sepse dëmi i përgojimit të dijetarit nuk kufizohet te dijetari, por mbi të dhe mbi dijen fetare që ai mbart.

E nëse njerëzit do e braktisnin dijetarin, ose nëse ai do të binte nga syri ityre

(do t'i binte vlera tek ata), atëherë do të binte edhe fjala e tij, edhe nëse ai thotë të vërtetën dhe udhëzon për tek ajo. Padyshim se përgojimi i këtij dijetari do të bëhet pengesë mes njerëzve dhe dijes së tij fetare, gjë e cila është rrezik shumë i madh.

Them: Të rinjtë duhet t'a konsiderojnë kundërshtimin e ndodhur mes dijetarëve se të gjithë kanë pasur qëllim të mirë dhe janë përpjekur për njohjen e të saktës, dhe t'i justifikojnë aty ku kanë gabuar disa prej tyre. Nuk ka ndonjë ndalim që ata të flasin me dijetarët për ato gjëra që mendojnë se ata kanë gabuar, me qëllim që të bëhet e qartë nëse gabimi qëndron tek dijetart apo tek ata që thonë se ata kanë gabuar.

Kjo sepse ndonjëherë njeriu kujton se fjala e dietarit është gabim dhe pas diskutimit me të, del që fjala e dietarit është e saktë. Por njeriu është njeriu dhe: **“Të gjithë bijtë e Ademit gabojnë, por gabuesit më të mirë janë ata të cilët pendohen.”** [Hadith Hasen. E ka nxjerrë Ibën Maxheh 4251.]

Por që të gëzohesh me një rrëshqitje të vogël të dietarit dhe me gabimin e tij, pastaj ta përhapësh atë në mesin e njerëzve dhe të ndodhë përçarje, kjo nuk është nga rruga e selefëve.

Po kështu edhe në lidhje me gabimet që ndodhin nga pushtetarët, nuk na lejohet që gabimet e tyre t'i marrim si shkallë për t'i sharë në çdo gjë dhe t'i mbyllim sytë para të mirave që ata kanë, sepse Allahu thotë në librin e Tij:

“O besimtarë! Bëhuni të qëndrueshëm në urdhrat e Allahut dhe bëhuni dëshmues me drejtësi! Le të mos ju nxisë urrejtja ndaj njerëzve për të bërë padrejtësi.” [El Maide, 8] D.m.th. të mos ju shtyjë urrejtja për dikë që

të mos mbash drejtësi, sepse mbajtja e drejtësisë është obligim dhe nuk i lejohe askujt që t'i marrë gabimet dhe rrëshqitjet e një dijetari apo pushtetari, apo edhe njerëzve të tjerë, e t'i përhapë ato në mesin e njerëzve, pastaj të heshtë nga të mirat e tyre [Nga kjo fjalë e shejhut mund të kuptohet se ai mbështet “Menhexhel muvazanat” – metodën e barazpeshimit, por nuk është ashtu, pasi që shejhu flet për dijetarët dhe pushtetarët në veçanti, ndërsa metoda e barazpeshimit ka për qëllim mbrojtjen e bidatçinjve duke përmendur edhe të mirat e tyre përkrah të këqiave dhe bidateve. Pra, medito! Në lidhje me metodën e barazpeshimit lexo librin “Metodologjia e pasuesve të sunetit dhe xhematit në kritikën e individëve, librave dhe grupeve” të shejh Rabij ibën Hadi el Med-hali.]

Kjo nuk është drejtësi.

Krahasoje këtë gjë tek vetja jote; sikur dikush të të bjerë më qafë, të përhapë rrëshqitjet dhe të këqiat e tua dhe të mos i përmendë të mirat dhe çështjet ku ja ke qëlluar të vërtetës, ti do ta konsiderojë këtë

një krim të tij ndaj teje.

N.q.s. e sheh kështu te vetja jote, atëherë kështu duhet ta shohësh edhe tek të tjerët. Dhe siç e përmenda më sipër, ilaçi për atë që mendon se është e gabuar, është që të lidhesh me atë që mendon se ka gabuar, të diskutosh me të dhe pas diskutimit qartësohen gjërat.

Sa njerëz ka që pas diskutimit janë kthyer nga fjala e tyre te ajo që është e vërtetë dhe sa njerëz ka që pas diskutimit ka dalë që fjala e tyre të jetë e vërtetë?!

Pra, “Besimtari për besimtarin është si ndërtesa, elementet përbërëse të së cilës mbajnë njëra-tjetrën.” [Buhariu 481, Muslimi 2585.]

I Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: “Kush dëshiron që të largohet prej zjarrit (të xhehenemit) dhe të hyjë në xhenet, le t’i vijë vdekja duke qenë se ai beson në Allahun dhe në botën tjetër, dhe të silltet me njerëzit ashtu si dëshiron të sillen me të.” [E ka nxjerrë Muslimi 1844.]

Kjo është drejtësia dhe qëndrueshmëria në të drejtën.

10. Të kapurit për Kuranin dhe Sunetin:

Nxënësi i dijes e ka obligim që të kujdeset për kërkimin e dijes dhe marrjen e saj nga burimet e saj, dhe nëse nuk fillon me këto burime, ai nuk ka shpëtim dhe sukses. Ato burime janë:

A - Kurani i ndershëm: nxënësi i dijes e ka obligim që të t'i përkushtojë kujdes leximit të Kuranit, mësimin të tij përmendësh, kuptimit të tij dhe të vepruarit me të, sepse Kurani është Litari i fortë i Allahut dhe baza e dijeve.

Selefët i përkushtonin kujdes të veçantë Kuranit, sa që janë përcjellë lajme të habitshme për ta në lidhje me këtë. Është përcjellë për shembull, se dikush prej tyre e mësoi të gjithë Kuranin kur ishte ende shtatë vjeç, dikush tjetër e mësoi atë për më pak se një muaj. Kjo tregon se selefët i përkushtonin kujdes të veçantë Kuranit.

Pra, nxënësi i dijes e ka obligim që të tregojë kujdes për Kuranin dhe ta mësojë atë tek ndonjë mësues, pasi që Kurani merret nëpërmjet mësimit të drejtpërdrejtë nga mësuesi. Por për të ardhur keq, gjen disa prej nxënësve të dijes që të mos e kenë mësuar Kuranin përmendësh, madje as të mos e lexojnë mirë atë, gjë e cila është mangësi e madhe në kërkimin e dijes.

Ndaj e përsëris se nxënësit e dijes e kanë vaxhib që të kujdesen për mësimin përmendësh të Kuranit, të punojnë me të, ftojnë tek ai dhe ta kuptojnë atë në përputhje me kuptimin e selefëve tanë të mirë.

B - Suneti i saktë: burimi i dytë i shariatit Islam, i cili është sqarues i Kuranit. Nxënësi i dijes e ka vaxhib që t'i bashkojë të dyja: Kuranin dhe Sunetin, dhe të përkujdeset për to.

Nxënësi i dijes duhet që ta mësojë Sunetin; ose duke mësuar tekstet e haditheve, ose duke mësuar zinxhirët e transmetimit të tyre bashkë me tekstet dhe

dallimin e hadithit të saktë nga i dobt. Po ashtu, ruajtja e sunetit bëhet edhe me mbrojtjen e tij dhe kundërpërgjigjen ndaj dyshimeve që hedhin ndjekësit e bidatit për Sunetin.

Nxënësi i dijes duhet të kapet për Kuranin dhe Sunetin e saktë, të cilat janë për të si krahët për zogun, të cilit nëse i thyhet njëri krah, nuk mund të fluturojë. Ndaj nuk duhet që të kujdesesh për Sunetin dhe të lësh Kuranin në harresë dhe as të kujdesesh vetëm për Kuranin dhe të lësh Sunetin në harresë.

Shumë prej nxënësve të dijes angazhohen me Sunetin, librat e sqarimit të tij, të transmetuesve të tij dhe terminologjisë së tij, në mënyrë të plotë, por nëse i pyet për një ajet nga Libri i Allahut, i gjen të mos dinë asgjë për të. Ky është një gabim i madh. Kurani dhe Suneti duhet të jenë si dy krahë për ty, o nxënës i dijes!

Por ekziston edhe një gjë e tretë e rëndësishme:

C - Fjala e dijetarëve: mos e neglizho fjalën e dijetarëve dhe mos e lër në harresë, pasi që dijetarët janë më të zhytur në dije se sa ti dhe ata dinë rregulla dhe fshehtësi të sheriatit që ti nuk i di. Ndaj edhe dijetarët e mëdhenj analistë e verifikues, kur arrinin në një përfundim, ata thonin: **“N.q.s. ndokush prej dijetarëve e ka thënë këtë fjalë, e mbështes dhe e publikoj, e nëse jo, atëherë nuk e them atë dhe tërhiqem nga ajo.”**

P.sh. dijetari i madh i Islamit, Ibën Tejmije, me gjithë dijen dhe kulturën e tij të gjerë, kur thoshte ndonjë fjalë të cilën nuk dinte ta kishte thënë ndokush tjetër para tij, ai thoshte: **“E them këtë fjalë nëse ndokush më parë e ka thënë atë.”**

Kështu që është detyrë për nxënësin e dijës që të kthehet te Libri i Allahut dhe Suneti i të Dërguarit të Tij (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), si dhe të ndihmohet me fjalët e dijetarëve.

Kthimi tek Libri i Allahut bëhet duke e mësuar atë përmendësh, duke medituar në

të dhe duke vepruar sipas asaj që thuhet në të, sepse Allahu thotë: **“Ky (Kuran) është një libër i bekuar, që Ne ta kemi zbritur ty (Muhamed), për të përsiatur thellë vargjet e tij dhe për t’u këshilluar me të njerëzit e mençur.”** [Sad, 29]

Përsiatja e ajeteve shpie në perceptimin e domethënies, ndërsa këshillimi në këtë rast është të vepruarit me këtë Kuran. Për këtë urtësi është zbritur Kurani, e përderisa është kështu, atëherë le të kthehemi tek ai duke medituuar në të, duke mësuar domethëniet e tij dhe pastaj të praktikojmë atë që thuhet në të.

Betohem në Allahun, se në Kuran gjendet lumturia e kësaj bote dhe e botës tjetër! Allahu i Madhëruar thotë: “... kush do ta pasojë udhëzimin Tim, as nuk do të humbë, as nuk do të bjerë në mjerim. Kushdo që i kthen shpinën Këshillës Sime, do të ketë jetë të mjeruar dhe Ne, në Ditën e Kiametit, do ta ringjallim të verbër.” [Ta Ha, 123-124]

Ndaj nuk gjen asnjë më të qetë, më të sigurtë dhe më rehat se besimtari, edhe nëse është i varfër. Besimtari është nga njerëzit më të sigurtë, më të qetë dhe më pa strese. Lexoni po të doni Fjalën e Allahut të Lartësuar: **“Cilindo mashkull apo femër që kryen vepra të mira, duke qenë besimtar, Ne do ta bëjmë që të kalojë jetë të bukur dhe do ta shpërblejmë sipas veprave më të mira, që ka bërë.”** [En Nahl, 97]

Cila është jeta e bukur?

Përgjigja: Jeta e bukur dhe e mirë është çlirimi i gjoksit dhe qetësia e zemrës, edhe nëse njeriu është në skamje. I Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: **“Çudi me çështjen e besimtarit! Çështja e besimtari është e gjitha hajër, dhe kjo nuk është veçse për besimtarin; nëse e kap ndonjë e keqe, ai duron dhe kjo është hajër për të, dhe nëse i vjen ndonjë e mirë, ai falënderon dhe kjo është hajër për të.”** [Muslimi 2999.]

A duron kafiri kur e kap ndonjë e keqe?

Përgjigja: Jo, nuk duron, por mërzhitet dhe i ngushtohet dynjaja, madje mund të varet e të vrasë veten, ndërsa besimtari duron dhe gjen që shija e durimit të jetë qetësi dhe siguri, ndaj jeta e tij është e bukur.

Prej këtu, domethënia e Fjalës së Allahut: **“Ne do ta bëjmë që të kalojë jetë të bukur”**, d.m.th. jetë të bukur e të mirë në zemrën dhe shpirtin e tij.

Disa historinë të cilët kanë shkruar për jetën e Ibën Haxherit (RahimehUllah), i cili ka qenë kryegjykatës i Egjiptit në kohën e vet, dhe kur shkonte në vendin e punës, shkonte me karrocë që tërhiqej nga kuajt. Një ditë kaloi pranë një burri jehudi shitës vaji, - dhe zakonisht ata që shesin vaj i kanë teshat të ndotura -. Ky jehudiu erdhi dhe e ndali karrocën, pastaj i tha Ibën Haxherit: **“Pejgamberi juaj thotë: “Kjo botë është burg për besimtarin dhe xhenet për kafirin.”** [Muslimi 2956.] **Ndërsa ti je kryegjykatës i Egjiptit, shkon e vjen me**

këtë karrocë dhe i ke të gjitha të mirat. Ndërsa unë - thotë jehudiu, jetoj në këtë vuajtje e mjerim që sheh!”

Ibën Haxheri i tha: “Në krahasim me të mirat e xhenetit, këto të mira në të cilat jetoj unë konsiderohen burg. Ndërsa vuajtja dhe mjerimi në të cilin jeton ti, konsiderohet xhenet në krahasim me dënimin e zjarrit.”

Atëherë jehudiu tha: “Dëshmoj se nuk ka zot tjetër përveç Allahut dhe dëshmoj se Muhamedi është i Dërguari i Allahut.” Dhe u bë musliman.

Pra, besimtari është në mirësi në çdo rast dhe ai e ka fituar këtë botë dhe botën tjetër, ndërsa mosbesimtari është në mjerim dhe ai e ka humbur këtë botë dhe botën tjetër.

Allahu i Lartësuar thotë: “Për kohën! Me të vërtetë, njeriu është në humbje, përveç atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, i këshillojnë njëri-tjetrit të vërtetën e i këshillojnë njëri-tjetrit durimin.” [El Asr, 1-3]

Kafirrat dhe ata të cilët e kanë humbur fenë e Allahut dhe janë zhytur në dëshirat dhe kënaqësitë e tyre, edhe nëse ata ndërtojnë kështjella të larta e të forta, edhe nëse u buzëqesh dynjaja, por në realitet ata jetojnë në ferr, ndaj dikush prej selefëve ka thënë: **“Sikur ta dinin mbretërit dhe bijtë e tyre se në çfarë mirësie jemi, do të na fshikullonin me shpata.”**

Ndërsa besimtarët janë në mirësi me lutjen që i bëjnë Allahut dhe me përmendjen e Tij, me besimin në paracaktimin e Allahut dhe përmbushjen e tij; nëse i kap ndonjë e keqe, ata durojnë dhe nëse u vjen ndonjë e mirë, falënderojnë Allahun, kështu që janë si s'ka më mirë , ndryshe nga njerëzit e dynjasë, të cilët janë ashtu si i ka përshkruar Allahu në Fjalën e Tij: **“Nëse u jepet diçka prej saj (lëmoshës), ata kënaqen, e nëse nuk u jepet gjë prej saj, ata menjëherë zemërohen.”** [Et Teube, 58]

Po kështu kthimi tek Suneti i Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), të cilin e kemi para duarve dhe të ruajtur mirë, uel hamdu lillah. Madje edhe ato fjalë

që i janë mveshur Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) i kemi të gjitha. Dijetarët i kanë ndarë dhe i kanë sqaruar ato që i janë mveshur Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) dhe nuk janë fjalë të tij dhe kështu, suneti ka mbetur i pastër dhe i ruajtur. Çdokush mund të arrijë tek ai duke iu kthyer librave të sunetit nëse mundet, ose duke pyetur dijetarët.

Por, nëse dikush thotë: Si bashkon ti mes fjalës që the më parë për t’u kthyer te Libri i Allahut dhe Suneti i Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), kur ne shohim se shumë njerëz ndjekin librat e shkruara në medh’hebet e ndryshme?

Dhe thonë: **“Unë kam këtë medh’heb, ndërsa unë këtë medh’heb.”** Madje kur i jep përgjigje dikujt që pyet dhe i thua se kështu ka thënë Pejgamberi (sal- lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), ai të thotë: **“Unë jam Hanefi, ose Malikij, ose Shafii, Hanbelij, e kështu.”**

- **Përgjigja:** është që t’u themi atyre: Që të gjithë ne themi: **“Dëshmoj se nuk ka të adhuruar tjetër (me të drejtë)**

përveç Allahut dhe dëshmoj se Muhamedi është i Dërguari i Allahut.”

Çdo të thotë të dëshmosh se Muhamedi është i Dërguari i Allahut?

- Dijetarët kanë thënë: “Domethënia e saj është: “T’i bindesh Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) në ato që urdhëron, t’i besosh në ato që njofton, të largohesh nga ato që ndalon dhe të mos e adhurosh Allahun veçse me atë që ligjëruar ai (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem).”

N.q.s. dikush thotë: “Unë kam këtë medh’heb”, dhe dikush tjetër: “Unë kam këtë medh’heb”!

I themi atij: Kur flitet për fjalën e Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), mos e kundërshto atë me fjalën e askujt tjetër. Vetë imamët e medh’hebeve kanë ndaluar nga imitimi i verbër i tyre dhe kanë thënë: **“Kur të bëhet e qartë e vërteta, është vaxhib që të kthehesh tek ajo.”**

I themi atij që na kundërvihet me medh’hebin e filanit apo të filanit:

“Që të dy ne dëshmojmë se Muhamedi është i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), dhe domethënia e kësaj është që të mos ndjekim askënd tjetër përveç Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), rruga (suneti) e të cilit gjendet para durave tona i qartë dhe i sqaruar.”

Por nuk kam për qëllim me këtë fjalë që të ul rëndësinë e kthimit tek librat e fukahave dhe dijetarëve. Përkundrazi, ne duhet të kthehemi tek librat e tyre për të përfituar prej tyre dhe për të njohur rrugët e nxjerrjes së ligjeve nga burimet e tyre, pa kthimin tek të cilat nuk vërtetohet kërkimi i dijes.

Ndaj gjejmë shumë rrëshqitje te ata njerëz të cilët nuk e marrin dijen në duart e dijetarëve, për shkak se ata vështrojnë me vështrim më të pakët se ç’duhet të shihnin. Marrin për shembull, Sahihun e Buhariut dhe argumentojnë me hadithet që gjenden në të, pa marrë parasysh se në të ka hadithe të përgjithshme dhe të veçanta, të pakufizuara dhe të kufizuara, si dhe hadithe të abroguara gjithashtu, por ata

nuk i kuptojnë këto dhe kështu ndodh humbje e madhe.

11. Verifikimi dhe vendosmëria:

Nga moralet më të rëndësishme me të cilat duhet të mvishet nxënësi i dijes është: verifikimi. Verifikimi i lajmeve që përcjell dhe verifikimi i gjykimeve që jep. Kur del një lajm, pikë së pari ai duhet verifikuar nëse është i vërtetë deri tek ai të cilit i mvishet. Pastaj, nëse vërtetohet, duhet të sigurohesh për dhënien e gjykimit, sepse mundet që lajmi i përcjellë të jetë ndërtuar mbi një bazë të cilën ti nuk e njeh dhe kështu gjykon se është i gabuar, ndërkohë që ai nuk është i gabuar. Cili është ilaçi në këtë rast?

Ilaçi është që të lidhesh me atë person të cilit i mvishet lajmi dhe t'i thuash: “Për ty është përcjellë kështu e kështu”, a është e vërtetë kjo?” Pastaj diskuto me të, edhe pse mohimi dhe kundërshtimi yt ndaj tij është gjëja e parë që sa e dëgjon lajmin e tij, pasi që ti nuk e di shkakun e atij lajmi.

Ndaj edhe thuhet: “Kur mësohet shkakun, ikën çudia!”

Pra, së pari duhet të sigurohesh, pastaj të lidhesh me personin nga i cili ka dalë ajo fjalë dhe ta pyesësh nëse është e vërtetë apo jo, pastaj të diskutosh me të; dhe nga diskutimi do të dalë nëse është ai në të vërtetë dhe të saktë, kështu që ti do të kthehesh te fjala e tij, ose do të jetë e sakta me ty, dhe ai duhet të kthehet te fjala jote.

Ka dallim ndërmjet vendosmërisë dhe verifikimit:

- Vendosmëria është: “Durim dhe këmbëngulje, moslodhje dhe mosmërzitje. Të mos marrësh nga çdo libër një pikë dhe nga çdo degë një copë, pastaj t’i lësh të gjitha, sepse kjo gjë e dëmton rëndë nxënësin dhe i merr ditë e ditë pa përfituar në to.”

Disa nxënës për shembull, lexojnë në gramatikë herë nga libri “**El Axhrumije**” p.sh, herë nga libri “**Katru en Nida**”, dhe herë nga “**Elfijetu Ibni Malik**”. Po kështu edhe në Terminologjinë e Hadithit; herë lexojnë nga libri “**En Nuhbe**”, herë nga “**El Elfije**” e El Irakit. Po kështu në Fikh, herë

lexojnë nga **“Zadul Mustekni”**, herë nga **“Umdetul Ahkam”**, herë nga **“El Mugni”** dhe herë nga **“Sherhul Muhedheb”**. E kështu me çdo libër të çdo fushe, por në shumicën e rasteve diçka e tillë nuk sjell përfitim në dije. Edhe nëse arrin ndopak dije, ajo dije lidhet me degët dhe jo me bazat, dhe mësimi i degëve një nga një është si ai që kap karkaleca një nga një.

Por e rëndësishme është marrja e bazave, vënia rrënjë dhe vendosmëria. Kjo është e rëndësishmja. Bëhu i qëndrueshëm në librat që lexon dhe u kthehesh, dhe bëhu i qëndrueshëm tek mësuesit gjithashtu. Mos u bëj provues; duke ndërruar çdo javë apo çdo muaj nga një mësues. Në fillim vendos se nga cili shejh do e marrësh dijen, pastaj qëndro me vendosmëri tek ai.

Por nuk ka problem nëse zgjedh një mësues për marrjen e fikhut nga ai, një tjetër për marrjen e gramatikës, një tjetër për teuhidin dhe akiden. E rëndësishme është që të vazhdosh me këmbëngulje deri në fund dhe jo të provosh e të bëhesh si ai burri që sa herë martohet me një grua dhe

qëndron me të shtatë ditë, e divorcon dhe shkon e kërkon grua tjetër!

Po kështu edhe verifikimi është shumë i rëndësishëm, sepse transportuesit e lajmeve ndonjë herë kanë referime të këqia dhe përcjellin gjëra që prishin imazhin e personit në fjalë me qëllim dhe vetëdije, ndërsa ndonjë herë tjetër nuk kanë referime të këqia por i kuptojnë gjërat ndryshe nga qëllimi që kanë pasur. Ndaj verifikimi është i detyrueshëm.

Pastaj, nëse vërtetohet me anë të përcjellësve një lajm i caktuar, vjen radha e diskutimit me personin për të cilin bëhet fjalë para se të gjykosh për gabimin apo mosgabimin e tij. Kjo sepse nga diskutimi mund të bëhet e qartë se e vërteta është me personin për të cilin u hapën fjalë.

12. Përkujdesja për kuptimin e qëllimit të Allahut të Madhëruar dhe qëllimit të Pejgamberit të Tij (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem):

Nga çështjet e rëndësishme në kërkimim e dijes është çështja e kuptimit, d.m.th. të kuptuarit e qëllimit të Allahut dhe qëllimit të të Dërguarit të Tij (sal- lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), pasi që shumë prej njerëzve u është dhënë dije, por nuk u është dhënë kuptim. Nuk mjafton të mësosh Kuranin dhe hadithet përmendësh pa i kuptuar ato. Duhet patjetër të kuptosh nga fjalët e Allahut dhe të Dërguarit të Tij (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) atë që kanë për qëllim.

Shumë gabime shkaktohen nga ata njerëz të cilët argumentojnë me tekstet e sheriatit ndryshe nga ajo që ka pasur për qëllim Allahu ose i Dërguari i Tij (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), dhe kështu ndodh humbje e madhe.

Tërheq vërejtjen këtu në një pikë të rëndësishme: Gabimi në kuptim mund të jetë më i rrezikshëm se gabimi për shkak të mosdijes, sepse ai i cili nuk ka dije dhe gabon, e di që është i paditur dhe mëson, ndërsa ai i cili i ka kuptuar tekstet gabim, kujton në vetvete se është i ditur dhe e ka mirë, duke besuar se kjo është ajo që ka pasur për qëllim Allahu dhe i Dërguari i Tij (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem).

- Të marrim disa shembuj me qëllim që të na bëhet më e qartë rëndësia e të kuptuarit:

Shembulli i parë: Allahu i Lartësuar thotë: “(Kujtoje) edhe Dautin dhe Sulejmanin, kur gjykuan mbi të lashtat në të cilat kishin kullotur natën bagëtitë e disa njerëzve. Ne ishim dëshmitarë të gjykimit të tyre. Ne e bëmë Sulejmanin ta kuptonte drejtë çështjen dhe, që të dyve u dhamë pushtet e dituri. Ne i nënshtroam malet dhe shpendët që, bashkë me Daudin, të thurnin lavde (për Allahun). Ishim Ne që i bënim këto.” [El Enbija, 78-79]

Allahu e privilegjoji Sulejmanin mbi Daudin (‘alejhis–selam) me të kuptuarin në këtë çështje, ndaj tha: **“Ne e bëmë Sulejmanin ta kuptonte drejtë çështjen”**, por pa ulur nga vlera e Daudit (‘alejhis–selam), sepse **“Që të dyve u dhamë mençuri e dituri.”**

Vëre në këtë ajet, kur Allahu përmend dallimin e Sulejmanit me të kuptuar, menjëherë pas kësaj përmend edhe atë me të cilën dallohej Daudi (‘alejhis–selam), ndaj tha: **“Ne i nënshtruam malet dhe shpendët që, bashkë me Daudin, të thurnin lavde (për Allahun).”** Dhe kështu barazohen që të dy.

Pra, Allahu ka përmendur cilësitë e përbashkëta tek të dy: pushtetin dhe diturinë, pastaj ka përmendur cilësinë e veçantë tek secili prej tyre, gjë e cila na tregon rëndësinë e të kuptuarit dhe se dija nuk është gjithçka.

Shembulli i dytë: N.q.s. ke dy enë; në njërën prej tyre ka ujë të nxehtë dhe në tjetrën ujë të ftohtë brisk, duke qenë se jemi

në dimër. Vjen një burr i cili kërkon të lahët nga xhenabeti dhe dikush i thotë: **“Më mirë është që të përdorësh ujin e ftohtë, sepse në larjen me ujë të ftohtë ka më shumë mundim dhe Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: “A t’ju tregoj një vepër me të cilën Allahu ju fshin gjynahet dhe ju ngre gradët?”** Thanë: **“Po, o i Dërguari i Allahut.”** Tha: **“Marrja mirë abdes kur mundoheni për këtë...”** [Muslimi 251.]

D.m.th. të lash mirë gjymtyrët gjatë abdesit në ditët e ftohta, dhe që ta bësh këtë me ujë të ftohtë është më mirë se me ujë të ngrohtë për t’ju përshtatur motit, sipas tij.

Pra, ky njeri jep fetva se përdorimi i ujit të ftohtë është më mirë dhe solli argument hadithin e mësipërm. A është gabimi këtu në dije apo në tëkuptuar?

Përgjigja: Sigurisht që gabimi këtu është në të kuptuar, sepse Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: **“Marrja mirë abdes kur ka mundim”** dhe nuk ka thënë që të zgjedhësh ujin e ftohtë për të marrë

abdes. Kuptimi i hadithit është: **“Nuk duhet që njeriun ta ndalojë fakti se uji është i ftohtë nga të marrët mirë abdes.”**

Përveç kësaj themi: A do Allahu lehtësim për robët e Tij, apo vështirësim?

- Përgjigja është në Fjalën e Allahut: **“Allahu do lehtësim për ju dhe nuk do vështirësim.”** [El Bekare, 185]

Si dhe në fjalën e Pejgamberit (sal-Allahu ‘alejhi ue sel-lem): **“Feja është lehtësim.”** [Buhariu 39.]

U them nxënësve të dijes: Çështja e të kuptuarit është shumë e rëndësishme, ndaj ne duhet të kuptojmë se çfarë kërkon Allahu nga robët e Tij? A ka për qëllim që t’ua vështirësojë atyre kryerjen e adhurimeve, apo do që t’ua lehtësojë atyre? Padyshim se Allahu do lehtësim për ne dhe jo vështirësim.

Këto ishin disa morale dhe edukata me të cilat duhet të mvishet nxënësi i dijes dhe t’i praktikojë në dijen e tij, me qëllim që të jetë shembull i mirë, thirrës në të mirë dhe prijës në fenë e Allahut. Me durim dhe

bindje të fortë arrin të bëhesh prijës në fe (dijetar), siç ka thënë Allahu i Madhëruar: **“Ne zgjodhëm prej tyre prijës, të cilët udhëzonin me urdhrat Tanë, për sa kohë që ishin të durueshëm dhe besonin bindshëm.”** [Es Sexhde, 24]

02. Shkaqet ndihmuese për marrjen e dijes:

Shkaqet ndihmuese për marrjen e dijes janë të shumta, por ne po përmendim:

- **Së pari:** Devotshmëria:

Devotshmëria është porosia e Allahut për njerëzit e mëparshëm dhe të mëvonshëm prej robërve të Tij. Allahu i Madhëruar thotë: “Ne i kemi porositur ata që u është shpallur Libri para jush dhe juve: “Frikësojuni Allahut! Nëse mohoni, dijeni se Allahut i përket gjithçka që gjendet në qiej dhe në Tokë. Allahu është i Vetëmjaftueshëm dhe i Denjë për çdo lavdërim.” [En Nisa, 131]

Devotshmëria është gjithashtu porosi e të Dërguarit të Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) për ymetin e tij. Ebu Umame Sadij ibën Axhlan el Bahili (radijAll-llahu anhu) se ka thënë: “Kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut (sal- lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), në Haxhin e Lamtumirës, të thotë: **“Ruajuni me devotshmëri Zotit tuaj, falni pesë namazet tuaja, agjëroni muajin tuaj (Ramazanin), jepni zekatin e pasurisë suaj, bindjuni prijësve tuaj, që të hyni në xhenetin e Zotit tuaj.”** [Tirmidhiu 616. Shejh Albani e ka konsideruar Sahih, në Es Silsiletu es Sahiha 867.]

Kur Pejgamberi dërgonte ndonjë komandant me grup zbulimi, e porosiste në veçanti për devotshmëri ndaj Allahut në veten e tij dhe që të kishte kujdes muslimanët që kishte me vete.

Po kështu edhe të parët e singertë porositnin gjithnjë për devotshmëri në hytбет, në shkrimet dhe në amanetet e tyre të vdekjes.

Umer ibën el Hatab i shkroi birit të tij, Abdullahit: “Unë të porosis për devotshmëri ndaj Allahut të Madhëruar, sepse kush i ruhet Allahut, Allahu e ruan atë, kush i jep borxh Atij (duke i dhënë sadaka të varfërve), Ai e shpërblen atë dhe kush e falënderon Atë, Ai ia shton atij.”

Po kështu Aliu (radijAll-llahu anhu) porositi një burrë me fjalët: “Të porosis për devotshmëri ndaj Allahut, të Cilin ke për ta takuar patjetër, nuk ke për të përfunduar veçse tek Ai, dhe Ai e sundon dynjanë dhe ahiretin.”

Dikush prej njerëzve të mirë i shkroi një vëllai të tij në fe: “Të porosis për devotshmëri ndaj Allahut i Cili të përgjigjet kur e lut në veten tënde dhe të mbikqyr në publik, ndaj mbaje Allahun në mendje, në çdo gjendje që të jesh, natë e ditë. Kije frikë Allahun aq sa afër teje është Ai dhe sa fuqi ka Ai mbi ty. Dhe dije se ti je në Syrin e Tij dhe nuk del nga pushteti i Tij në pushtetin e dikujt tjetër (kudo që të shkosh), as nga zotërimi i Tij në zotërimin e dikujt tjetër. Le të jetë sa më i madh ruajtja jote nga Ai dhe

sa më e madhe frika jote ndaj Tij. Ues selam!”

- Domethënia e devotshmërisë **(et takva)** është: **“Të vendosësh pritë mrojtëse mes teje dhe asaj që i frikësohesh.”**

- Ndërsa domethënia e devotshmërisë ndaj Allahut është: **“Të vendosësh mes teje dhe asaj që ke frikë prej zemërimit dhe pakënaqësisë së Allahut mburojë mbrojtëse, me kryerjen e urdhrave të Tij dhe largimin nga ndalesat e Tij.”**

Dije se ndonjëherë devotshmëria përmendet e shoqëruar nga vepra e mirë, ndaj thuhet: **“vepër e mirë dhe devotshmëri”**, si në Fjalën e Allahut: **“Ndhmojeni njëri-tjetrin në vepra të mira dhe devotshmëri...”** [El Maide, 2] Dhe përmendet gjithashtu e vetme. Kur përmendet bashkë me veprën e mirë, atëherë vepra e mirë është kryerja e të urdhëruarave ndërsa devotshmëria është lënia e të ndaluarave. Ndërsa kur përmendet e vetme, atëherë përfshin kryerjen e të urdhëruarave dhe largimin nga të ndaluarat.

Allahu ka përmendur në Kuran se xheneti është përgatitur për të devotshmit; njerëzit e devotshëm janë banorët e xhenetit, Allahu na bëftë prej tyre! Ndaj njeriu duhet të ketë devotshmëri ndaj Allahut, në bindje të Urdhrit të Tij, në kërkim të shpërblimit të Tij dhe për të shpëtuar nga dënimi i Tij. Allahu i Madhëruar thotë: **“O besimtarë! Nëse i frikësoheni Allahut, Ai do t’ju japë aftësinë e të gjykuarit drejt, do t’ju fshijë gjynahet tuaja dhe do t’ju falë. Allahu zotëron mirësi të madhe.”** [El Enfal, 29]

Ky ajet përmban tre dobi të rëndësishme:

- **Dobia e parë: “do t’ju japë aftësinë e të gjykuarit drejt”** d.m.th. ju jep aftësinë që të dalloni mes të vërtetës dhe të pavërtetës dhe mes të dobishmes dhe të dëmshmes. Këtu hyn edhe dija, duke i hapur Allahu njeriut dije të cilën nuk ja ka hapur njeriu tjetër. Me devotshmëri arrihet shtim i udhëzimit, shtim i dijes dhe shtim i mbatjes përmendësh, ndaj përcillet se imam Shafiu ka thënë:

Iu ankova Vekijut

për dobësinë e mësimit përmendësh

Ai më këshilloi të largohem nga gjynahet

Dhe tha: dije se dija është dritë

Dhe drita e Allahut nuk i jipet gjynahqarit

Pa dyshim se sa më shumë që të shtohet dija e njeriut, aq më shumë i shtohet njohuria dhe aftësia e të dalluarit mes të vërtetës dhe të kotës dhe mes të dobishmes dhe të dëmshmes. Këtu hyn edhe të kuptuarit që Allahu i jep dikujt, sepse devotshmëria është shkak për kuptimin e fortë dhe nga kuptimi i fortë rrjedh shtim i dijes. Sheh p.sh. dy njerëz të kenë mësuar të njëjtin ajet nga Libri i Allahut; njëri prej tyre nxjerr prej tij tre rregulla sheriati ndërsa tjetri mundet që të nxjerrë më shumë se kaq, në varësi të të kuptuarit që i ka dhënë Allahu. Pra devotshmëria është shkak për shtimin e dijes.

Këtu hyn gjithashtu edhe mprehtësia, d.m.th. që Allahu i jep të devotshmit

mprehtësi me të cilën ai dallon edhe njerëzit. Mjafton që ta shohë dikënd, dhe e di nëse ai është gënjeshtar apo i sinqertë, vepërmirë apo vepërkeq. Madje mund të gjykojë mbi një person pa jetuar me të dhe pa ditur asgjë për të, bazuar në mprehtësinë që i ka dhënë Allahu.

- **Dobia e dytë: “do t’ju fshijë gjynahet tuaja”;** fshirja e gjynaheve bëhet me kryerjen e punëve të mira, sepse punët e mira i fshijnë ato të këqiat, ashtu si ka thënë Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): **“Pesë namazet, nga e xhumaja në të xhumanë tjetër dhe nga Ramazani në Ramazanin tjetër, të gjitha këto janë fshirje të gjynaheve që bëhen mes tyre, përderisa mënjanohen gjynahet e mëdha.”** [Muslimi 233.]

Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) gjithashtu ka thënë: **“Nga Umra në Umra të fshihen gjynahet e bëra mes tyre.”** [Buhariu 1773, Muslimi 1349.]

Pra, fshirja e gjynaheve bëhet me kryerjen e veprave të mira, gjë e cila do të thotë se nëse njeriu i frikësohet Allahut, atëherë i bëhet e lehtë kryerja e veprave të mira me të cilat Allahu i fshin atij gjynahet.

- **Dobia e tretë: “dhe do t’ju falë”**, duke ua bërë të mundur kërkimin e faljes dhe pendimin, gjë e cila është mirësi nga Allahu për robin e Tij.
- **Së dyti:** Këmbëngulja dhe vazhdimësia në kërkimin e dijes

Nxënësi i dijes e ka detyrim që të japë të gjithë mundin e tij në kërkim të dijes, të jetë i durueshëm në kërkimin e saj dhe pasi ta marrë atë, ta ruajë mirë, sepse dija nuk arrihet me rehati të trupit. Nxënësi i dijes duhet të ndjekë të gjitha rrugët e mundshme për të arritur dijen dhe ai ka shpërblim tek Allahu

për këtë, siç përmendet në Sahihun e Muslimit se Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: **“Kushdo që ndjek një rrugë për të kërkuar dije, Allahu i lehtëson atij një rrugë për në xhenet.”** [E transmeton Muslimi.]

Pra, nxënësi i dijes duhet të jetë këmbëngulës dhe të përpiqet me të gjitha forcat, të kalojë netët pa gjumë dhe të lerë gjithçka që e largon dhe e preokupon nga të

kërkuarit e dijes.

Neve na janë përcjellë tegime të shquara nga selefët në lidhje me këmbënguljen në kërkimin e dijes, sa që transmetohet se Ibën Abasi u pyet një herë: **“Si e arrite dijen që ke?”** Ai tha: **“Me gjuhë që pyet shumë, me zemër që kupton (me përkushtim të vëmendjes) dhe me trup të palodhur.”**

Është përcjellë gjithashtu nga Ibën Abasi (radijAll-llahu anhu) se ai ka thënë: “... Kur mësoja se dikush dinte një hadith, shkoja te dera e shtëpisë së tij, dhe ndërsa ai pushonte në kohën e drekës, unë shtroja rrobën time dhe mbështetësha para derës së tij dhe era më hidhte pluhurin në fytyrë.” Kur ai dilte, më thoshte: “O biri i xhaxhait të Pejgamberit, çfarë të ka sjellë këtu? Përse nuk dërgove dikënd të më kërkove që të vija?” Ndërsa unë i thosha: “Unë e kam për detyrë që të vij tek ti. Pastaj e pyesja për hadithin...” Pra, Ibën Abasi ishte i thjeshtë në kërkimin e dijes, ndaj Allahu e ngriti atë me dijen.

Kështu duhet të jetë nxënësi i dijes, të këmbëngulë shumë në kërkimin e dijes.

Është përcjellë gjithashtu nga Imam Shafiu (RahimehUllah) se atë e ftoi Imam Ahmedi (RahimehUllah) një natë dhe pasi hëngrën darkë, u ndanë dhe secili shkoi të flerë në shtratinn e tij. Imam Shafiu mendohej për nxjerrjen e gjykimeve nga një hadith, pikërisht nga fjala e Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): **“O Eba Umejri, çfarë bëri Nugajri?!”** [Buhariu 6129.] Ebu Umejri, një fëmijë i vogël kishte në dorë një zog të vogël të cilit i thoshin Nugajr. Ky zogu ngordhi dhe Ebu Umejri u mërzi për të, ndërsa Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), i cili luante edhe me fëmijët e vegjël dhe i fliste çdo njeriu ashtu si i përshtatej, i tha këto fjalë. Imam Shafiu ndenji duke medituuar në këtë hadith dhe thuhet se nxorri prej tij më shumë se njëqind dobi. Ndoshta kur nxirrte një dobi, atij i vinte ndërmend një hadith tjetër dhe kështu. Kur u thirr ezani i sabahut, Shafiu u ngrit të shkojë të falej dhe nuk mori abdes, pastaj shkoi në shtëpinë e vet.

Imam Ahmedi fliste mirë për imam Shafiun te njerëzit e shtëpisë së tij, ndërsa ata i thanë: “O Ebu Abdullah! Si e lavdëron një njeri i cili hëngri e piu, pastaj fjeti dhe nuk u ngrit natën (që të falej) dhe e fali namazin e sabahut pa abdes?!”

Këto pyetje i shkuan Imam Shafiut dhe ai tha: “Fakti që hëngra sa e zbraza sahanin, kjo sepse unë nuk kisha provuar ushqim më të shijshëm se ai i imam Ahmedit, kështu që doja të mbushja barkun me të. Fakti që nuk u ngrita të falem natën, kjo për shkak se dija është më e mirë se namazi i natës, ndërsa unë meditoja rreth këtij hadithi. Ndërsa fakti që unë nuk mora abdes për namazin e sabahut, kjo sepse kisha abdes që nga namazi i jacisë, dhe nuk doja t’i mundoja të më sillnin ujin e abdesit.”

Them: Në çdo rast, këmbëngulja në kërkimin e dijes është gjë shumë e rëndësishme. Nëse do të vështronin në aktualitetin tonë sot, a jemi ne këmbëngulës ashtu si duhet?

- Përgjigja është **“Jo!”**

Edhe ata të cilët mësojnë në mënyrë akademike, pas mësimit ata ndoshta merren me gjëra të cilat nuk i ndihmojnë ata në mësimet e tyre.

- Po marr një shembull, por duke dashur që si ky shembull të mos ketë njeri: Njëri prej nxënësve përgjigjet keq në pyetjet e një lënde dhe mësuesi i thotë: **“Përse kështu?”** Ky i përgjigjet: **“Sepse i kam humbur shpresat nga të kuptuarit e kësaj lënde, kështu që nuk mësoj fare për të, por vetëm sa desha ta mbart atë (pa e kuptuar).”**

E shihni si është humbja e shpresës?! Sigurisht që ky është një gabim shumë i madh. Ne duhet të këmbëngulim deri sat ë arrijmë qëllimin.

Më ka treguar shejhu ynë këmbëngulës, Abdurrahman es Seadi (RahimehUllah); se është përcjellë nga El Kesai, imami i banorëve të Kufës në sintaksën e gjuhës arabe, se ky iu fut kërkimit të kësaj shkence por nuk mundi të vazhdonte. Më pas, një

ditë prej ditësh, ai pa një milingonë që mbarte ushqim për vete dhe ngjitej me të në shpinë mbi një mur. Sa herë që ngjitej deri diku, ajo rrëzohej dhe përsëri ngjitej, e kështu deri sa me këmbëngulje e kapërceu atë pengesë dhe e ngjiti murin. Atëherë El Kesai tha: **“Kjo milingonë këmbënguli deri sa ia arriti qëllimit.”** Atëherë edhe ai këmbënguli deri sa u bë prijës në sintaksë.

Ndaj, o nxënës të dijes, ne duhet të këmbëngulim dhe të mos dorëzohemi, sepse dorëzimi është mbyllje e derës së hajrit, dhe të mos jemi pesimistë por optimistë.

- **Së treti:** Mësimi përmendësh:

Nxënësi i dijes duhet të kujdeset për përsëritjen e mësimëve dhe ruajtjen e asaj që mëson duke i mësuar përmendësh në gjoksin e tij ose duke i shkruar, sepse njeriu harron dhe nëse i kujdeset për përsëritjen e atyre që mëson, atëherë ato humbin dhe harrohen. Ndaj thuhet në poezi:

Dija është gjah dhe shkruajtja është litari i tij

Ndaj lidhe gjahun tënd me litarë të fortë

*Sepse është budallallëk që të gjuash një
kaproll*

Pastaj ta lësh atë të lëshuar në mes të pyllit

Prej rrugëve që të ndihmojnë në ruajtjen e dijes dhe përforcimin e saj është që njeriu të udhëzohet me dijen e tij. Allahu i Madhëruar thotë: **“Ata të cilët janë udhëzuar, Ai (Allahu) ua shton edhe më shumë udhëzimin dhe u jep atyre devotshmëri.”** [Muhamed, 17]

Dhe thotë: “Allahu ua shton edhe më shumë udhëzimin atyre të cilët janë udhëzuar.” [Merjem, 76]

Sa më shumë që njeriu të punojë me dijen e tij, aq më shumë i shtohet mbajtja përmendësh dhe kuptimi i saj, sipas kuptimit të përgjithshëm të Fjalës së Allahut: **“ua shton edhe më shumë udhëzimin.”**

- **Së katërti:** Qëndrimi pranë dijetarëve:

Nxënësi e dijes e ka obligim që së pari të mbështetet për ndihmë tek Allahu i Madhëruar pastaj t'u kërkojë ndihmë dijetarëve si dhe të ndihmohet me atë që kanë shkruar në librat e tyre; pasi që të përqendruarit vetëm në thjesht leximin e librave kërkon kohë të gjatë, ndryshe nga ai që ulet para një dijetari i cili i shpjegon atij, i sqaron dhe i ndriçon rrugën.

Megjithatë, unë nuk them se dija nuk merret veçse drejtpërdrejt nga dijetarët, sepse mundet që dikush të marrë dije edhe duke lexuar shumë, por në shumicën e rasteve, edhe nëse ka bërë përpjekje të plota natë e ditë, edhe nëse i është dhuruar kuptim, ai mund të gabojë shumë, sepse siç thuhet: **“Kush ka librin drejtues të tij, gabimet e tij janë më shumë se të saktat e tij.”**

Por në të vërtetë ky rregull nuk është i prerë, por rruga më e mirë është që dija të merret nga mësuesit (**shejhat**), dhe unë e këshilloj nxënësin e dijes gjithashtu që të

mos marrë nga shumë shejha në të njëjtën fushë, si p.sh. të mësojë fikhun me më shumë se një shejh, sepse dijetarët ndryshojnë nga mënyra e të argumentuarit me Kuranin dhe Sunetin, si dhe ndryshojnë në mendimet e tyre gjithashtu. Ti zgjidh një dijetar nga i cili merr fikhun, një tjetër nga i cili merr gjuhën, e kështu; d.m.th. çdo fushë të dijes ta mësosh në shujuh të ndryshëm. E nëse një shejh është i specializuar në më shumë se një fushë të dijes, nuk ka problem të qëndrosh me të në ato fusha. Por nëse e merr fikhun për shembull nga dy shejha të ndryshëm, dhe ata kanë mendime të ndryshme në disa çështje, atëherë cili do të jetë qëndrimi yt, ti që je nxënës?

Qëndrimi yt do të jetë pështjellimi dhe dyshimi. Ndaj qëndro tek një dijetar për mësimin e një fushe të caktuar të dijes, dhe kjo të bën të jesh rehat dhe i qetë.

Kapitulli i tretë.

Rrugët e marrjes së dijes dhe disagabime nga të cilat duhet pasur kujdes.

01. Rrugët e marrjes së dijes:

Është mëse e ditur se kur njeriu synon të arrijë në një vend, duhet patjetër që njohë rrugën që të çon atje, e nëse ka më shumë se një rrugë për te ai vend, atëherë zgjedh më të shkurtrën dhe më të lehtë e tyre. Prej këtui, është shumë e rëndësishme që nxënësi i dijes ta ndërtojë kërkimin e dijes mbi baza dhe rregulla dhe të mos i ngatërrojë gjërat e t'i bëjë lëmsh, sepse **“kush nuk i zotëron bazat, nuk mund të arrijë te synimi.”**

Poeti thotë:

Dija është det i madh i mbushur plot

*Fundin e të cilit nuk mund ta arrijë kushdo që
të përpiqet*

*Por në bazat e saj gjen lehtësim për arritjen e
saj*

Ndaj kujdesu për to, dhe ke për të gjetur rrugë

Shfrytëzoi rregullat dhe bazat

Sepse kush i humb ato, nuk arrin

Bazat janë dija dhe çështjet e ndryshme janë degët. Njësoj si rrënjët e pemës dhe degët e saj; n.q.s degët nuk janë mbi rrënjë të mira e të forta, atëherë ato dobësohen dhe vdesin.

Por, çfarë janë bazat?

A mos janë argumentet e sakta?

Apo rregullat dhe disiplinat? Apo që të dyja këto së bashku?

- **Përgjigja:** Bazat janë argumentet e Kuranit dhe të Sunetit, rregullat dhe disiplinat e përfituara nga vrojtimi dhe vëzhgimi i kujdesshëm dhe i studiuar nga Kurani dhe Suneti. Këto janë gjërat më të rëndësishme për të cilat ka nevojë nxënësi i dijes.

- Për shembull, rregulli: “Mundimi dhe vështirësia tërheq lehtësimin”, është marrë nga Kurani dhe Suneti.” Nga Kurani është marrë nga Fjala e Allahut të Madhëruar: “Ai (Allahu) nuk u ka ngarkuar me ndonjë vështirësi në fe.” [El Haxh, 78]

Ndërsa nga Suneti, nga fjala e Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ku i thotë Imran ibën Husajnit: “**Falu duke qëndruar në këmbë, e nëse nuk mundesh, atëherë falu i ulur, e nëse përsëri nuk mundesh, atëherë falu i mbështetur.**” [Buhariu dhe Muslimi.]

Si dhe nga fjala e Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): “**Kur iu urdhëroj**

për diçka, bëni prej saj sa të mundeni.”

[Buhariu dhe Muslimi.]

Duke ditur këtë rregull, sikur të të vijjnë një mij çështje të formave të ndryshme, ti do të keshë mundësi të gjykosh për secilën prej tyre duke u bazuar mbi këtë rregull. Por sikur të mos e dish këtë rregull, ka për t'u pështjelluar çështja qoftë edhe nëse të vijjnë vetëm dy çështje apo pyetje.

Për marrjen e dijes ka dy rrugë:

- **Rruga e parë:** Marrja e saj nga librat e besueshëm dhe të saktë të cilët i kanë shkruar dijetarët e njohur për dijen e tyre, besnikërinë dhe akiden e tyre të pastër prej bidateve dhe trillimeve.

Duke e marrë dijen nga librat mund të arrish në një synim të caktuar, por këtu has dy vështirësi:

- **E para:** Koha e gjatë. Njeriut i duhet shumë kohë, përpjekje e stërmundim që të arrijë atë dije që synon, vështirësi të cilën ndoshta nuk e përballojnë shumë prej njerëzve, sidomos kur sheh të tjerët rreth përreth që të kenë humbur shumë kohë pa pasur dobi, dhe kështu të hyn dembelizmi, lodhja dhe neveritja, dhe nuk e arrin atë që

synon.

Vështirësia e dytë: Në shumicën e rasteve, dija e atij i cili e merr dijen vetëm nga librat është e dobët dhe mbi të nuk ndërtohen rregulla e baza. Ndaj gjejmë shumë gabime tek ata të cilët e marrin dijen nga librat, pasi që nuk kanë baza dhe rregulla mbi të cilat mbështetet dhe mbi të cilat të ndërtojnë degëzimet që gjenden në Kuran dhe në Sunet. Gjejmë disa njerëz që të mbështeten në një hadith i cili nuk ekziston në librat e konsideruara të hadithit prej **“Sahihave”**, apo **“Mesanideve”**, etj, rrugë e cila është në kundërshtim me bazat e konsideruara tek dijetarët, madje tek i gjithë ymeti musliman, pastaj i gjejmë ata të marrin këtë hadith dhe të ndërtojnë akiden e tyre mbi të, gjë e cila padyshim që është gabim, pasi që Kurani dhe Suneti kanë disa baza rreth të cilave sillen çështjet dhe degët e ndryshme. Dhe duhet patjetër që këto degëzime t'i ballafaqosh me bazat, në mënyrë që nëse në këto degëzime gjen diçka në kundërshtim me bazat dhe nuk mund të bashkohet mes tyre, atëherë i lëmë këto

degëzime.

Rruga e dytë: për kërkimin e dijes është: të kërkuarit e saj nga një mësues i besueshëm në dijen dhe fenë e tij. Kjo rrugë është më e shpejtë dhe më e sigurtë për kërkimin e dijes, pasi që në rrugën e parë mundet që kërkuesi të humbë rrugë pa e ditur për shkak të kuptimit të gabuar ose mosditurisë, apo për shkaqe të tjera. Ndërsa rruga e dytë përmban diskutim, marrje e dhënie me mësuesin, duke bërë që nxënësit ti hapen dyer të shumta të kuptimit, verifikimit, mënyrës së mbrojtjes së fjalëve të vërteta dhe kundërpërgjigjes ndaj fjalëve të dobëta.

E nëse kërkuesi i dijes bashkon mes këtyre dy rrugëve, kjo është më e mira dhe më e plota.

Nxënësi i dijes duhet të fillojë me më të rëndësishmet dhe me versionet e shkurtuara në shkencat e ndryshme para atyre të zgjatura, në mënyrë që të ngjitet shkallë pas shkalle, dhe të mos ngjitet në një shkallë më lart pa e zotëruar mirë atë

para saj, me qëllim që ngjitja e tij të jetë e saktë dhe e sigurtë.

02. Gabime prej të cilave duhet pasur kujdes:

Disa prej nxënësve të dijes bienë në disa gabime, prej të cilave përmendim:

01. Zilia (El Hased)

Zilia është: urrejtja e asaj mirësie që Allahu i ka dhënë dikujt tjetër. Ajo nuk është dëshira për largimin e mirësisë së Allahut nga tjetri, por thjesht urrejtja e asaj mirësie që Allahu ia ka dhënë dikujt tjetër. Kjo është zilia, qoftë kur dëshiron heqjen e asaj mirësie nga tjetri apo vazhdimësinë e saj, por e urren atë.

Në këtë përfundim ka arritur shejhu i Islamit, Ibën Tejmije (RahimehUllah), i cili thotë: **“Zilia është urrejtja e asaj mirësie të cilën Allahu ia ka dhënë dikujt tjetër.”**

Zilia është diçka nga e cila thuajse nuk mund të shpëtojë shpirti, d.m.th. që ajo mund të jetë e domosdoshme për të, por në hadith ka ardhur kjo thënie: **“Nëse të hyn zilia, mos bëj zullum, dhe nëse të hyn dyshimi, mos vepro (sikur të ishte i vërtetë).”** [E ka përmendur Ibën Haxheri në “Fet’hul Bari” me sened Mursel. Por hadithi ka dëshmuar të tjerë të nxjerrë nga Bejhakiu në :Shuabul **“Iman”** dhe Ibën Abdulberr në **“Et Temhid.”**] D.m.th: Kur njeriu sheh se ka zili në zemrën e tij për ndokënd, atëherë të mos i bëj zullum atij me fjalë apo vepër, sepse kjo është prej cilësive të çifutëve, për të cilët Allahu i Madhëruar thotë: **“Apo mos kanë zili njerëzit për çfarë u ka dhuruar atyre Allahu nga Begatitë e Tij? Dhe Ne që më parë i kishim dhënë familjes së Ibrahimit Librin dhe urtësinë dhe u dhuruam atyre mbretërim madhështor.”** [En Nisa, 54]

Përveç kësaj, ziliqari bie në shumë gjëra të ndaluara:

01 - Urrejtja e asaj që ka caktuar Allahu, pasi që urrejtja e asaj mirësie të cilën Allahu ia ka dhënë atij personi është urrejtje e asaj që ka caktuar Allahu për të ndodhur si dhe kundërshtim i përmbushjes së paracaktimit të Allahut.

02 - Zilia i ha veprat e mira ashtu si zjarri ha drutë, sepse në shumicën e rasteve ziliqari i bën zullum atij që ka zili duke përmendur ato që urren tek ai, duke larguar njerëzit prej tij, duke i ulur vlerën, e ngjashëm me këto, gjëra të cilat janë nga gjynahet e mëdha dhe që mund të fshijnë veprat e mira.

03 - Ajo që ndodh në zemrën e ziliqarit prej hidhërimit, ferrit dhe zjarrit i cili e ha nga brenda. Sa herë që ky sheh një mirësi tek ai që ka zili, vreriset dhe i ngushtohet gjoksi. Gjithnjë e ruan dhe e studion atë person dhe sa herë që Allahu i jep mirësi atij, ky mërzhitet, vreriset dhe i ngushtohet dynjaja.

04 - Në të pasurit zili ka përngjasim me çifutët, dhe siç dihet: kush vepron një prej cilësive të mosbesimtarëve, ai është prej tyre në atë cilësi, bazuar në fjalën e Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem):

“Kushdo që i përngjason një populli, ai është prej tyre.” [E ka nxjerrë Ahmedi 5/5, Ebu Daudi, El Hejthemi 10/271. Ahmed Shakir e ka konsideruar të saktë në **“El Musned”** të imam Ahmedit, hadithi nr. 5114.]

05 - Sado që zilia jote të rritet dhe të forcohet, nuk mundesh kurrë që ta heqësh mirësinë e Allahut nga ai person që ti ke zili. Dhe përderisa kjo është e pamundur, atëherë përse të kesh zili?!

06 - Zilia e pengon plotësimin e besimit, sepse Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: **“Askush nga ju nuk beson deri sa të dojë për vëllanë e tij atë që do për vete.”** [Buhariu.] Kjo do të thotë se ti duhet të urresh heqjen e mirësisë nga vëllai yt dhe nëse nuk e urren këtë gjë, atëherë ti nuk do për vëllanë tënd atë që do për vete, gjë e cila e pengon plotësimin e besimit.

07 - Zilia bën që të mos i kërkosh Allahut nga mirësitë e Tij, por të preokupohesh me mirësinë që Allahu i ka dhënë dikujt tjetër, ndërsa Allahu thotë: **“Dhe mos dëshironi ato gjëra me të cilat Allahu ka bërë që**

disa prej

jush të dallohen nga të tjerët. Për burrat do të ketë shpërblim për çfarë ata kanë fituar dhe për gratë do të ketë shpërblim për çfarë ato kanë fituar dhe kërkon Allahut nga Begatitë e Tij. Allahu është kurdoherë i Gjithëdituri për çdo gjë.” [En Nisa, 32]

08 - Zilia bën që ziliqari t'i përbuzë mirësitë e Allahut mbi të, d.m.th. ziliqari sheh se nuk është në mirësi, ndërsa tjetri është në mirësi më të madhe se ky. Dhe kështu, ai i përbuz mirësitë e Allahut mbi të dhe si rrjedhojë nuk falënderon për to.

09 - Zilia është moral i keq, pasi që ziliqari ndjek mirësitë e Allahut tek njerëzit e shoqërisë së tij dhe përpiket me sa të mundet që të largojë njerëzit nga personi që ky ka zili, herë duke i ulur vlerën, herë me përçmimin e veprave të mira që ai bën, e herë me gjëra të tjera.

10 - Kur ziliqari ka zili, në shumicën e rasteve ai i bën zullum tjetrit dhe kështu ai tjetri merr prej të mirave të këtij deri sa të mos mbesë gjë prej tyre, pastaj merren prej të këqia të këtij dhe i hidhen mbi shpinë

ziliqarit, pastaj hidhet në zjarr.

- **Përfundimi është:** se zilia është moral negativ dhe për të ardhur keq, ajo ekziston më së shumti mes dijetarëve dhe nxënësve të dijes, mes tregtarëve, mes kolegëve dhe atyre që kanë të njëjtin profesion. Por për të ardhur keq, ajo ekziston më shumë mes dijetarëve dhe mes nxënësve të dijes, megjithëse më parësore dhe më e lartë do të ishte që poseduesit e dijes të ishin njerëzit më larg zilisë dhe më afër moraleve të përsosura.

Vëlla! Nëse sheh se Allahu i ka dhënë mirësi një robi të Tij, përpiqu të bëhesh si ai dhe mos e urre atë person të cilit Allahu i ka dhënë mirësi, por thuaj: **“O Zot! Shtoja atij mirësinë Tënde dhe më jep mua edhe më të mirë se atij!”** Zilia nuk ndryshon asgjë nga gjendja aktuale, por siç e përmendëm më sipër, ajo përmban këto dhjetë negativitete dhe të ndaluara, dhe kush mediton më tepër mund të gjejë edhe më shumë se këto, e Allahu është Ndihmuesi më i mirë!

02. Dhënia fetva pa pasur dije:

Të qenurit myfti është post i lartë, pasi që personi që ka këtë post përballet me sqarimin e gjërave që u ngatërrohen masës së gjerë të popullit në çështjet e fesë duke i drejtuar ata në rrugën e drejtë. Ndaj këtë post madhështor nuk mund ta marrë veçse dikush që është kompetent, kështu që njerëzit duhet të kenë frikë Allahun e Madhëruar dhe të mos flasin veçse me dije dhe mendjehollësi. Duhet ta dinë se vetëm Allahut i takon krijimi dhe urdhri.

Nuk ka krijues tjetër përveç Allahut, nuk ka rregullues e sistemues tjetër të

krijesave përveç Allahut dhe nuk ka ligj tjetër për krijesat përveç ligjit të Allahut. Allahu është Ai i Cili e bën të detyrueshme diçka dhe të ndaluar një gjë tjetër. Ai bën të preferuar diçka dhe e bën të lejuar atë, ndërsa për ata të cilët bëjnë diçka të lejuar apo të ndaluar sipas dëshirës dhe pasionit të tyre, Allahu thotë: **“Thuaju: “Më thoni, çfarë të mirash ju ka zbritur juve Allahu!**

Dhe ju vetë i keni bërë ato të ligjshme e të paligjshme.” Thuaju: “A ju ka lejuar Allahu (të bëni kështu), apo ju shpifni gënjeshtër ndaj Allahut?” Dhe çfarë mendojnë ata që trillojnë gënjeshtër kundër Allahut, për Ditën e Kijametit (a mendojnë se do të falen)?” [Junus, 59-60]

Allahu i Madhëruar gjithashtu thotë: “Por mos thoni në lidhje me atë që jua thotë goja duke gënjyer: “Kjo është e ligjshme dhe kjo është e ndaluar”, që të shpifni gënjeshtër ndaj Allahut, (pasi) me të vërtetë ata të cilët shpifin gënjeshtër ndaj Allahut kurrë nuk do të fitojnë. (Veç) një kënaqësi të shpejtë e kalimtare do të shijojnë, por për ta do të jetë ndëshkim i dhimbshëm.” [En Nahl, 116-117]

Nga krimet më të mëdha është që dikush të thotë për diçka se ajo është hallall, duke qenë se nuk e di gjykimin e Allahut për të, ose që të thotë se ajo është haram, pa e ditur gjykimin e Allahut për të. Ose të thotë për diçka se ajo është vaxhib (**obligim**), duke mos e ditur nëse Allahu e ka bërë obligim apo jo, ose të thotë se nuk është

obligim, pa e ditur se Allahu nuk e ka bërë obligim atë. Ky është krim dhe sjellje e paedukatë me Allahun e Madhëruar.

Si është me ty, o njeri, që e di se gjykimi i takon vetëm Allahut, pastaj i paraprin Atij duke folur në fenë dhe sheriatin e Tij pa pasur dije?! Allahu e ka shoqëruar të folurit për Të pa dije me shirkun **(shokvënien)**, kur thotë: **“Thuaj: “(Por në të vërtetë) gjërat që i ka ndaluar Zoti im janë mëkatet që kryhen hapur ose fshehur, gjynahet (e tjera të çdo lloji), shtypja pa të drejtë, vënia shok Allahut në adhurim, gjë për të cilën Ai nuk ka dhënë asnjë të drejtë e asnjë provë, si dhe përfolja për Allahun për gjëra për të cilat ju nuk keni dijeni.”** [El Araf, 33]

Ka edhe shumë prej masës së gjerë të cilët i japin fetva njëri-tjetrit pa pasur dije. I gjen ata të thonë: **“Kjo është hallall”**, apo **“haram”**, apo **“obligim”**, apo **“nuk është obligim”**, duke qenë se nuk dinë asgjë për të. A nuk e dinë këta se Allahu ka për t'i pyetur ata në ditën e Kiametit për atë që thonë? A nuk e dinë këta se sikur të

humbin një person duke i bërë të lejuar atij diçka që është e ndaluar, apo duke i bërë të ndaluar diçka që është e lejuar, se atyre u kthehet gjynahu i tij dhe ata kanë gjynah njësoj si ai që vepron për shkak të gjykimit që i kanë dhënë atij?

Disa njerëz nga masat e gjera bëjnë një krim tjetër: kur shohin dikë që kërkon të pyesë ndonjë dijetar, i thonë atij: “Nuk është nevoja që të pyesësh për këtë. Kjo është diçka e qartë. Kjo është haram.” Ndërkohë që në realitet ajo është hallall ndërsa ky bën haram atë që Allahu e ka lejuar. Ose thonë: “Ky është obligim”, duke i ngarkuar diçka me të cilën nuk e ka ngarkuar Allahu, e kështu. Kjo gjë është krim ndaj sheriatit të Allahut dhe tradhti ndaj vëllait tënd musliman, pasi që i ke dhënë fetva pa pasur dije. Sikur dikush të të pyeste për rrugën që të shpie në filan vend, dhe ti t’i thoshe se rruga është këtej, pa e ditur se nga ishte rruga, a nuk e konsiderojnë njerëzit këtë gjë si tradhti nga ana jote? Atëherë si mundesh të flasësh për rrugën e xhenetit, e cila është sheriat i zbritur nga Allahu, ndërkohë që ti

nuk di gjë për të?!

- **O vëllezër!** Prej logjikës, besimit dhe frikës ndaj Allahut dhe madhërimit të Tij është që kur njeriu nuk e di diçka, të thotë: **“Nuk e di! Pyet dikë tjetër.”** Kjo gjë është nga logjika e shëndoshë, sepse kur njerëzit shohin që ai sigurohet para se të flasë, besojnë tek ai, dhe sepse ai e di vlerën e vetes dhe në këtë rast i jep asaj vendin që i takon. Kjo gjë është gjithashtu nga plotësimi i besimit në Allah, i frikës ndaj tij, pasi që ky nuk i paraprin Zotit të tij në dhënien e vendimeve dhe nuk përflet në fenë e Tij atë që nuk e di. Edhe i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), i cili është më i dituri prej krijesave të Allahut me fenë e Allahut, pyeste për ato gjëra për të cilat nuk kishte zbritur shpallje dhe priste t’i zbriste shpallja dhe Allahu t’i përgjigjej pyetjes së tij: **“Të pyesin ty (O Muhammed) se ç’është e lejuar për ta. Thuaj: “Të lejuara për ju janë të gjitha ushqimet e mira.” [El Maide, 4]. “Të pyesin ty (O Muhammed) edhe për Dhulkarnejnin. Thuaju: “Unë do t’ju rrëfej diçka nga historia e tij.” [El Kehf, 83] “Të pyesin ty (O Muhammed) për Orën (Çastin e Fundit, Kiametin): “Kur është përcaktuar koha e tij?” Thuaju: “Dija për të është Vetëm tek Zoti im. Askush nuk ta shpall kohën e tij përveç**

Atij.” [El Araf, 187]

Po kështu edhe shokët e Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), kur u paraqitej një çështje për të cilën nuk e dinin gjykimin e Allahut, ata kishin frikë dhe heshtnin përballë saj.

- Ebu Bekër es Sidiku (radijAll-llahu anhu) thotë: **“Ç’qell do të më mbulonte dhe ç’tokë do të më mbante sikur të flisja për librin e Allahut diçka pa pasur dije?!”**

- Kur Umer ibën el Hatabi (radijAll-llahu anhu) përballej me një çështje të re, mbledhte sahabet dhe konsultohej me ta.

- Ibën Sirin thotë: **“Nuk ka pasur më të ruajtur se Ebu Bekri në lidhje me atë që nuk e dinte dhe nuk ka pasur më të ruajtur pas Ebu Bekrit se sa Umeri.”**

- Ibën Mesudi (radijAll-llahu anhu) thotë: **“O njerëz! Kush pyetet për diçka që ai e di, le ta thotë atë, ndërsa kush nuk ka dije për atë që pyetet, të thotë: “Allahu e di”, pasi që prej dijes është që për atë që nuk e di, të thuash “Allahu e di.”**

Shebiu u pyet për një çështje dhe ai tha: **“Nuk e di mirë atë.”** Shokët i thanë: **“U turpëruam me ty!”** Ai tha: **“Por engjëjt nuk u**

turpëruarn kur thanë: “Ne nuk kemi dije përveç asaj që na ke mësuar Ti.” [El bekare, 32]

Shembujt ne lidhje me dhënien fetva pa pasur dije janë të shumtë. Prej tyre p.sh. kur të sëmurit i ndoten rrobat dhe ai nuk ka mundësi t'i pastrojë ato, dikush i thotë që të mos falet deri sa të pastrojë rrobat. Kjo është një fetva e pavërtetë dhe e gënjeshtërt, pasi që i sëmuri duhet të falet qoftë edhe me rroba të ndotura, qoftë edhe me trup të papastër përderisa nuk ka mundësi të pastrohet, sepse Allahu thotë: **“Kini frikë Allahun sa të mundeni...”** [Et tegabun, 16] Pra, të sëmurit i lejohet të falet sipas gjendjes së tij dhe sipas mundësisë që ka. Ai mund të falet në këmbë dhe nëse nuk mundet, atëherë mund të falet ulur, dhe nëse nuk mundet ulur, atëherë të falet i mbështetur dhe të bëjë me shenjë me kokën e tij nëse mundet, e nëse nuk mundet, atëherë bën me shenjë me sytë e tij, sipas mendimit të disa dijetarëve. Nëse as me sy nuk mundet dhe e ka mendjen në vend, atëherë bën nijet për kryerjen e veprave me

zemrën e tij dhe fjalët i thotë me gojë. P.sh: Të thotë: **“Allahu Ekber”**, pastaj të lexojë Fatihanë dhe një sure, pastaj të thotë: **“Allahu Ekber”** dhe të bëjë nijet për rënien në ruku, pastaj të thotë: **“Semiallahu limen hamideh”** dhe të bëjë nijet ngritjen nga rukuja. Po kështu të veprojë në sexhde dhe në veprat e tjera të namazit; të bëjë nijet me zemër veprën që nuk ka mundësi ta bëjë dhe të mos e vonojë namazin nga koha e tij.

Për shkak të kësaj fetvaje të gënjeshtërt mund të vdesin disa prej muslimanëve duke qenë lënë të namazit për shkak të saj, dhe sikur ata ta dinin se njeriu i sëmurë mund të falet në çdo gjendje që të jetë, do të vdisnin duke qenë që faleshin.

Çështjet si kjo dhe të ngjashme me të janë të shumta, ndaj masat e gjera duhet t'i mësojnë rregullat e këtyre çështjeve nga dijetarët me qëllim që të mësojnë gjykimin e Allahut për to dhe me qëllim që të mos flasin pa dije në fenë e Allahut.

03. Mendjemadhësia:

Mendjemadhësinë e ka sqaruar Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) me sqarimin më përmbledhës dhe më të qartë, kur thotë: **“Mendjemadhësia është mohimi i të vërtetës dhe përçmimi i njerëzve.”** [Muslimi.]

Mohimi i të vërtetës është kthimi mbrapsht i saj, ndërsa përçmimi i njerëzve është përbuzja e tyre. Prej mendjemadhësisë është edhe që t’ja kthesh mësuesit tënd, t’i flasësh pa turp dhe të sillesh keq me të.

Po kështu edhe shpërfillja e atij që të sjell një dobi por i cili është më i vogël se ti, është mendjemadhësi. Kjo ndodh tek disa nxënës të cilët kur i tregon diçka

dikush që është më poshtë gradës së tyre në dije, e shpërfill dhe nuk e pranon atë.

Neglizhimi yt në të punuarit me dijen tënde është shenjë humbjeje, Allahu na ruajtë!

Në lidhje me këtë, poeti thotë:

Dija është luftë për djaloshin kryelartë Ashtu siç është rrëkeja luftë për vendin e lartë

Domethënia e këtyre vargjeve është:

djaloshi kryelartë nuk mund ta arrijë dijen, pasi që dija është luftë për të ashtu si rrëkeja që është luftë për vendin e lartë, pasi që në vendin e lartë rrëkeja shkon majtas e djathtas dhe nuk qëndron mbi të. Po kështu edhe dija nuk qëndron me mendjemadhësinë dhe kryelartësinë, madje për shkak të këtyre dija mund të ikë nga njeriu.

04. Fanatizmi për një medh'heb apo një mendim:

Nxënësi i dijes duhet të zhvishet nga njëanshmëria dhe particizmi: që të mos e lidhë dashurinë dhe urrejtjen për hir të një grupi apo partie të caktuar, gjë e cila padyshim që është në kundërshtim me metodën e selefëve, të cilët nuk kanë qenë të ndarë në parti, por kanë qenë një parti e vetme, të përfshirë në Fjalën e Allahut: **“Është Ai (Allahu) që ju ka emëruar ju**

Muslimanë edhe më pare...” [El Haxh, 78]

Pra nuk ka particizëm dhe as ndarje në grupe, as miqësim dhe as armiqësim veçse sipas asaj që ka ardhur në Kuran dhe Sunet.

Ka prej njerëzve për shembull, që anëtarësohen në një grup të caktuar, themelojnë rrugën e tij, argumentojnë për të me argumente që mund të jenë kundër tij dhe jo në favor të tij dhe e mbrojnë atë, duke i quajtur grupet e tjera si të humbur edhe pse mund të jenë më pranë të vërtetës se sa këta. Pastaj marrin edhe parimin: **“Kush nuk është me mua është kundra meje”**, i cili është një parim i keq, pasi që mund të ketë të mesëm për ty ose kundër teje, dhe nëse është kundër teje me të drejtë, atëherë le të jetë kundër teje, sepse në fakt ai është me ty në këtë rast. Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) thotë: **“Ndhimoje vëllanë tënd qoftë ai i cili e bën padrejtësinë apo të cilit i bëhet padrejtësia.”** [Buhariu dhe Muslimi.] Ndhimesa e zullumqarit bëhet duke e ndaluar atë nga zullumi.

Në Islam nuk ka particizëm, andaj kur në mesin e muslimanëve u shfaqën partitë, u ndanë rrugët, u përça populli dhe njerëzit filluan të quajnë njëri- tjetrin të humbur, të hanë mishin e vëllait të tyre të vdekur, i ndoqi ata dështimi, siç ka thënë Allahu i Madhëruar: **“Mos u kundërshtoni me njëri- tjetrin që të mos humbni kurajon dhe të mos ju lënë fuqitë...”** [El Enfal, 46]

Dhe kështu, i gjejmë disa nxënës të dijes të cilët shkojnë tek një prej shejhave **(mësues, dijetar)**, që ta mbrojnë atë shejh me të drejtë dhe pa të drejtë, dhe lufton shejhat e tjerë, i quan të humbur dhe bidatçinj, dhe mendon se vetëm shejhu i tij është dijetar i vërtetë, ndërsa të tjerët janë injorantë ose prishës.

Padyshim që ky është një gabim shumë i madh. Ajo që duhet të merret është fjala e atij e cila është në përputhje me Kuranin, Sunetin dhe me fjalën e sahabeve të Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem).

05. Dalja në krye para kualifikimit:

Nga gjërat për të cilat duhet pasur kujdes është që nxënësi i dijes të dalë në krye para se të kualifikohet për të kryesuar dhe udhëhequr; e nëse ai e bën këtë, kjo argumenton për disa gjëra:

- **E para:** Pëlqimi i vetvetes për shkak të daljes në krye, duke e parë veten më të diturin e të diturve.
- **E dyta:** Kjo është argument për moskuptimin dhe mosnjohjen e tij të çështjeve, pasi që kur del në krye, ndodh që të has në një çështje nga e cila nuk mund të dalë, pasi që kur njerëzit e shohin atë të dalë në krye, i paraqisin atij çështje me të cilat zbulohet defekti dhe mangësia e tij.
- **E treta:** Kur del në krye para se të kualifikohesh, kjo të çon në të folurit për Allahun pa pasur dije, pasi që në shumicën e rasteve, ata që kanë për qëllim të udhëheqin, janë mospërfillës dhe përgjigjen për çdo gjë që pyeten, duke vënë në rrezik fenë e vet dhe duke folur për Allahun e Madhëruar pa pasur dije.
- **E katërta:** Kur njeriu del në krye, në shumicën e rasteve ai nuk e pranon të vërtetën, pasi që me mendjelehtësinë e tij ai kujton se sikur t'i nënshtrohet dikujt

tjetër qoftë edhe nëse e vërteta është me të, kjo do të ishte argument se ai nuk është dijetar.

06. Të pasurit mendim të keq për tjetrin:

Nxënësi i dijes duhet të ketë kujdes nga të pasurit mendim të keq për tjetrin, si p.sh. të thotë: “Ky nuk jep lëmoshë veçse për t’u dukur”, “ky nxënës nuk e ka bërë këtë pyetje veçse për t’u dukur dhe për t’u njohur se është nxënës që kupton.” Kështu bënë hipokritët në kohën e Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem); kur dikush prej besimtarëve sillte lëmoshë të madhe, ata thoshin: “E bën për sy të njerëzve”, ndërsa kur dikush sillte lëmoshë të pakët, ata thonin: “Allahu nuk ka nevojë për lëmoshën e këtij.” Allahu thotë për ta: **“Ata të cilët marrin nëpër gojë dhe tallen me besimtarë të atillë që japin**

Sadaka me vullnetin e tyre dhe (me) ata të cilët nuk mundën që të gjejnë për të dhënë Sadaka përveçse çfarë kanë në dorë, Allahu do t’ua përplasë vetë atyre

përqeshjen dhe për ta do të ketë dënim të dhimbshëm.” [Et Teube, 79]

Ruaju mendimit të keq për atë që në pamje të jashtme është i drejtë. Nuk ka dallim mes mendimit të keq për mësuesin tënd apo për shokun tënd, pasi që obligimi është që të kesh mendim të mirë për atë që në pamje të jashtme shfaq drejtësi. Ndërsa për atë që shfaq gjë tjetër nga e drejta, nuk ka problem që të kesh mendim të keq për të, por megjithatë ti duhet të sigurohesh për këtë me qëllim që të heqësh nga vetja iluzionin, pasi që disa njerëz mund të mendojnë keq për dikë duke u bazuar në një iluzion të rrejshëm dhe të pavërtetë.

Pra, detyra jote kur ti e prish mendimin për një person, qoftë ai nga nxënësit e dijes apo të tjerë, detyra jote është që të shohësh nëse ka prova të qarta që të shtyjnë ty të kesh mendim të keq. Përndryshe, nëse janë thjesht iluzione të tuat, atëherë nuk të lejohet ty që të mendosh keq për muslimanin i cili në pamje të jashtme shfaq drejtësi. Allahu i Madhëruar thotë: **“O ju që keni besuar! Largoni shumë prej**

dyshimeve.” [El Huxhurat, 12] Pra nuk thotë: **“Të gjitha dyshimet”**, pasi që disa dyshime kanë bazë dhe arsye. **“Vërtet disa nga dyshimet përbëjnë gjynah.”** Dhe jo të gjitha dyshimet. Ai dyshim nga i cili rrjedh armiqësi ndaj tjetrit, padyshim që është gjynah. Po kështu edhe dyshimi i pabazë. Por nëse dyshimi ka baza, atëherë nuk ka problem të mendosh keq në bazë të provave dhe argumenteve.

Prandaj nxënësi i dijes duhet t'i japë vetes vendin që i takon dhe të mos e ndotë atë me gjëra të ndyta, si dhe të ketë kujdes nga këto gabime që përmendëm, pasi që atë e ka nderuar Allahu me dije dhe e ka bërë shembull për të tjerët, sa që Allahu i ka kthyer çështjet e njerëzve, në të cilat hasin problem, tek dijetarët, kur thotë: **“Pyesni njerëzit e Mesazhit nëse nuk dini.”** [El Enbija, 7] **“Kur atyre u vjen rëndë ndonjë çështje që prek sigurinë e njerëzve apo frikë, ata e përhapin atë (ndër njerëz). Sikur t'ia kishin paraqitur atë (për shqyrtim) të Dërguarit apo njerëzve të tjerë drejtues të tyre, shqyrtuesit**

përkatës do ta kishin kuptuar atë prej tyre.” [En Nisa, 83]

Përfundimi është se ti, o nxënës dije, je i nderuar, ndaj mos e zbrit veten tënde në fushën e përçmimit dhe poshtërimit, por qëndro ashtu si duhet të jesh

Kapitulli i katërt.

Librat e nxënësit të dijes.

Në fillim të këtij kapitulli duhet patjetër që të sqarojmë disa çështje të rëndësishme për nxënësin e dijes. Ato çështje janë:

01. Si të sillemi me librin?

Sjellja me librin bëhet me disa gjëra:

E para: Njohja e subjektit të librit, me qëllim që të përfitosh prej tij në fushën që kërkon, pasi që mund të jetë libër magjie, fallesh apo me gjëra të pavërteta. Pra duhet patjetër që të njohësh subjektin e librit me qëllim që të arrish dobinë e kërkuar prej tij.

E dyta: Njohja e termave të përdorura në libër, gjë e cila zakonisht tregohet në parathënie e librit. Kjo është e rëndësishme pasi që kështu ti kursen shumë kohë, dhe prandaj dijetarët i vendosin parathënie librave.

P.sh: Ne e dimë se kur autori i librit **“Bulugul Meram”** thotë: **“Ky hadith është Muttefekun Alejhi”**, ka për qëllim Buhariun dhe Muslimin, ndërsa autori i librit **“Munteka el Ahbar”** ka për qëllim gjë tjetër. Kur thotë **“Muttefekun alejhi”** ai ka për qëllim se atë hadith e transmeton Ahmedi, Buhariu dhe Muslimi.

Po kështu në librat e Fikhut bëhet dallim mes termave **“dy thënie”**, **“dy drejtime”**, **“dy transmetime”**, **“dy mundësi”** e kështu. **“Dy transmetimet”** janë nga imami i medh’hebit. **“Dy drejtimet”** janë nga shokët e tij, dijetarët e mëdhenj të medh’hebit ata të cilët i japin drejtim gjërave në medh’heb. **“Dy mundësitë”** përdoret kur ka lëkundje mes dy thënieve dhe **“dy thëniet”** janë më të përgjithshme se të gjitha këto.

Po kështu duhet të dish p.sh. se kur autori thotë **“ixhmaan”** - në unanimitet, apo **“uifakan”** - në përputhje, në këtë rast me fjalën **“unanimitet”** është për qëllim unanimiteti i metit dhe kur thotë **“në përputhje”** d.m.th. në përputhje me tre imamët, siç e përdor

këtë shprehje autori i librit “**El Furu**” - Degëzimet, në fikun hanbeli. Po kështu edhe dijetarët e medh’hebeve të tjerë, secili ka termat e veta, kështu që duhet të njohësh termat që përdor autori.

E treta: Njohja e stilit dhe shprehjeve të librit, ndaj kur lexon një libër, dhe veçanërisht kur është libër shkencor i mbushur me dije, ndesh me shprehje të cilat kërkojnë meditim dhe mendim të thellë që t’i kuptosh, për shkak se ende nuk je mësuar me stilin e tij, por kur e lexon përsëri, mësohesh me të.

Ekziston edhe diçka tjetër jashtë sjelljes me librin, dhe bëhet fjalë për shënimet poshtë apo anash faqes. Nxënësi i dijes duhet t’i shfrytëzojë këto vende bosh në faqen e librit për të shënuar sqarimin, argumentin apo analizimin e një çështje që ndesh në libër dhe ka frikë se mos e harron. Shpesh njeriut i shpëtojnë këto dobi të cilat sikur t’i shënonte, nuk do i merrnin veçse një apo dy minuta kohë, dhe kur i kthehet përsëri atij libri, harxhon kohë të gjatë deri sa të kujtojë ku e ka lexuar atë dobi të

caktuar, madje ndoshta nuk e gjen më.

Pra, nxënësi i dijes duhet të kujdeset për këtë gjë, sidomos në librat e fikhut. Shpesh në librat e fikhut ndesh një çështje të caktuar bashkë me gjykimin e saj, për të cilën ti stepesh dhe ajo çështje të bëhet problematike. Kur kthehesh në librat e fikhut më të zgjeruara se libri që ke në dorë, dhe gjen atje një thënie e cila e sqaron plotësisht çështjen tënde, atëherë ti duhet ta shënosh këtë thënie me qëllim që të kthehesh tek ajo herë tjetër në rast nevojë, pa u kthyer përsëri tek libri i madh nga i cili e ke marrë atë. Kjo gjë të kursen shumë kohë.

02. Leximi i librave bëhet në dy mënyra:

E para: Lexim me vëmendje dhe përqendrim për të kuptuar. Në këtë mënyrë të të lexuarit, njeriu duhet të mendohet dhe të përqendrohet.

E dyta: Lexim dhe shfletim për të parë se për çfarë bën fjalë libri dhe çfarë kapitujsh përmban, duke e shfletuar shpejt atë, gjë në të cilët nuk përkushtohet vëmendje dhe përqendrim si në mënyrën e parë të leximit.

03. Grumbullimi i librave:

Nxënësi i dijes duhet të kujdeset për grumbullimin e librave, por duhet të fillojë nga më të rëndësishmit në më pak të rëndësishmit. Nëse njeriu ka pak mundësi financiare, nuk është prej hajrit dhe as prej urtësisë që të blejë shumë libra dhe të fus veten në borxhe për çmimin e tyre. Kjo është prej menaxhimit të keq. N.q.s. nuk ke mundësi të blesh një libër, atëherë ti mund ta marrësh atë hua nga ndonjë bibliotekë.

04. Përkujdesja për përvetësimin e librave të rëndësishme:

Nxënësi i dijes duhet të kujdeset për përvetësimin e librave nënë dhe bazë, dhe jo librat e shkruara së fundi, pasi që disa

autorë të rinj nuk janë në dijen e thelluar dhe me baza, ndaj kur lexon atë që kanë shkruar këta, i gjen gjëra sipërfaqësore. Mund edhe të kenë përcjellë shprehje të librave të vjetër, por me ndryshim të shprehjes duke e zgjatur atë me fjalë të shumta të pavlera.

Ndaj, kujdesu për librat nënë të selefëve, sepse ato janë shumë më të mira dhe më të begata se librat e halefëve **(të mëvonshmëve)**, dhe kjo sepse shumica e librave të këtyre të fundit janë kuptimpakë dhe shprehjeshumë, sa që lexon një faqe të tërë dhe mund ta përmbledhësh atë me një apo dy rreshta. Ndërsa librat e të parëve i gjen të lehta, të thjeshta, të arritshme dhe të matura. Madje nuk gjen një fjalë të vetme pa pasur kuptim.

Prej librave më madhështore për të cilat duhet të kujdeset nxënësi i dijes janë librat e shejhut të Islamit, Ibën Tejmijes (RahimehUllah) dhe librat e nxënësit të tij, Ibnul Kajjim (RahimehUllah). Siç është e njohur, librat e Ibnul Kajjim janë më të lehta dhe të thjeshta se ato të Ibën Tejmijes,

sepse Ibën Tejmije përdor shprehje të forta për shkak të dijes së tij të gjerë dhe forcës së intelektit të tij.

Ndërsa Ibnul Kajjim pa një shtëpi të ngritur dhe u preokupua me zbukurimin dhe renditjen e saj. Nuk kemi për qëllim këtu të themi se Ibnul Kajjim është kopje e Ibën Tejmijes. Përkundrazi, Ibnul Kajjim ka qenë i lirë në mendimet dhe zgjedhjet e tij, dhe kur shihte se shejhu i tij e kundërshtonte diçka që ky e shihte të saktë, atëherë ai fliste, siç ka bërë në lidhje me obligueshmërinë e shndërrimit të Haxhit në Umra për atë që nuk e sjell me vete kurbanin ndërkohë që ka bërë nijet për Haxh Mufrid apo Kiran, siç ishte edhe mendimi i Ibën Abasit (radijAll-llahu anhu). Ndërsa Ibën Tejmije kishte mendimin se kjo gjë ishte e obliguar në këtë mënyrë posaçërisht për sahabet. Pasi përmend fjalën e Ibën Abasit, ibnul Kajjim thotë: **“Unë më shumë anoj nga fjala e tij se sa nga fjala e shejhut tonë.”** D.m.th. shprehu kundërshtimin e tij.

Pra Ibnul Kajjim (RahimehUllah) ka qenë i pavaruar dhe i lirë në mendimet e tij, por nuk ka çudi që ai të përputhet me shehun e tij në atë që mendon se është e saktë dhe e vërtetë, dhe nuk ka dyshim se nëse ti i mendon thellë shumicën e zgjedhjeve të Ibën Tejmijes, i gjen se ato janë të sakta, gjë të cilën e njohin mirë ata që lexojnë librat e atyre dyve **(Ibën Tejmijes dhe Ibnul Kajjim)**.

05. Vlerësimi i librave

Librat ndahen në tre lloje:

Lloji i parë: Libra të hajrit

Lloji i dytë: Libra të sherrit

Lloji i tretë: Libra as të hajrit dhe as të sherrit

Ti kujdesu që libraria jote të mos përmbajë libra në të cilat nuk ka hajër, apo në të cilat ka sherr.

Ekzistojnë edhe disa libra të cilave u thuhet **“Libra letërsie”**, por në të vërtetë këto libra e therin kohën dhe e vrasin atë pa

përfituar dobi. Si dhe ekzistojnë gjithashtu libra të dëmshme që përmbajnë ide të caktuara, as këto mos i fut në librarinë tënde, qofshin ato në menhexh apo në akide, siç janë librat e bidatçnjve të cilat dëmtojnë akiden dhe librat revolucionare të cilat dëmtojnë menhexhin.

Në përgjithësi, çdo libër të dëmshëm mos e fut në librarinë tënde, pasi që librat janë ushqim për shpirtin njësoj si ngrënia dhe pirja për trupin, dhe nëse e ushqen shpirtin me libra të tillë, ty të shkaktohet dëm i madh dhe merr drejtim të kundërt me rrugën e saktë të nxënësit të dijes.

Librat e nxënësit të dijes: Së pari: Në Akide:

01 - Libri “Tre parimet” 02 - Libri “Katër bazat”

03 - Libri “Largimi i dyshimeve” 04 - Libri “Kitabu et Teuhid”

Të katërta këto libra janë të shejhut të Islamit, imam Muhamed ibën Abdulvehab (RahimehUllah).

05 - Libri **“Akidja el Vasitije”** e cila përmban sqarim të Teuhidit El Esma ue Sifat dhe është nga librat më të mirë që janë shkruar në këtë temë dhe e meriton të lexohet dhe të referohesh tek ai.

06 - Libri “El Hamavije”

07 - Libri **“Et Tedmurije”**, që të dy këto libra janë më të zgjeruara se libri **“El Vasitije”**. Të tre këto libra janë të shejhut të Islamit Ibën Tejmijes (RahimehUllah).

08 - Libri **“Akidja Tahavije”**, e shejh Ebu Xheafer Ahmed ibën Muhamed et Tahavi.

09 - Libri **“Sqarimi i Akides Tahavije”**, i Ebu el Hasen Ali ibën Ebil Iz (RahimehUllah).

10 - Libri **“Margaritarët shkëlqyes në përgjigjet Nexhdije”**, grumbullim i shejh Abdurrahman ibën Kasim (RahimehUllah).

11 - Libri **“Margaritarët ndriçues në akiden e grupit të pëlqyer”**, i Muhamed ibën Ahmed es Sefarini el Hanbeli, por duhet pasur parasysh se në të përmenden disa shprehje të cilat e kundërshtojnë menhexhin e selefëve, siç është fjala e tij:

*Zoti ynë nuk është as materie
dhe as gjë aksidentale*

*As trup nuk është Ai, i
Larti në lartësi*

Prandaj nxënësi i dijes duhet ta mësojë

akiden në duart e një shejhu i cili e njeh mirë akiden e selefëve, me qëllim që t'i sqarojë atij shprehjet dhe bindjet që janë në kundërshtim me akiden e selefëve.

Së dyti: Në Hadith:

01 - Libri **“Fet’hul Bari, sqarim i Sahihut të Buhariut”**, i ibën Haxher el- Askalnit (RahimehUllah).

02 - Libri **“Subulu as selam, sqarim i Bulugu al meram”**, i Saneanit, një libër i cili bashkon mes hadithit dhe fikhut.

03 - Libri **“Nejlu al eutar, sqarim i Munteka el Ahbar”** i Sheukanit.

04 - Libri **“Umdetu al Ahkam”** i El Makdesi, një libër i specializuar shumica e haditheve të të cilit janë në dy Sahihat dhe nuk është nevoja të kërkohet për saktësinë e tyre.

05 - Libri **“Dyzet hadithet e Neveviut”**, i Ebu Zekerija en Nevevi RahimehUllah Ky libër është shumë i mirë sepse në të ka mësimet të mira, stil të mirë dhe rregulla shumë të dobishme, siç është p.sh. hadithi: **“Nga islami i mirë i njeriut është lënia e asaj që nuk i intereson.”** [Hadith Sahih. E ka nxjerrë Tirmidhiu 2324, Ibën Maxheh 3976.] Ky hadith është një rregull, po të ecësh sipas të cilit, do të ishte i mjaftueshëm. Po kështu edhe rregulli në lidhje me të folurin: **“Kush beson Allahun dhe botën tjetër, të flasë mirë ose të heshtë!”** [Buhariu 6018, Muslimi 47.]

06 - Libri **“Bulugu al Meram”**, i Hafidh ibën Haxher el-Askalnit, një libër shumë i dobishëm veçanërisht me faktin se ai përmend transmetuesit e haditheve dhe se kush e ka konsideruar të saktë apo të dobët një hadith të caktuar, si dhe bën shënimet e veta në hadithe.

07 - Libri **“Nuhbetu el fikr”**, i ibën Haxher el-Askalnit, i cili konsiderohet një libër përmbledhës. Sikur nxënësi i dijes ta kuptojë dhe ta përvetësojë këtëlibër, ai i mjafton në vend të shumë librave në

terminologjinë e hadithit. Në këtë libër, Ibën Haxheri ka edhe një stil shumë të dobishëm, i cili është: shqyrtimi dhe ndarja. Kur e lexon këtë libër, nxënësi i dijes është aktiv pasi që ai është i ndërtuar në atë mënyrë që të kërkon të vesh mendjen në punë. Madje unë them se nxënësi i dijes bën mirë ta mësojë përmendësh atë, sepse ai është një përmbledhje e dobishme në shkencën e hadithit.

08 - Gjashtë Sunenet: Sahihu i Buhariut, Sahihu i Muslimit, Sunenu en Nesai, Sunenu Ebi Daud, Sunenu Ibën Maxheh dhe Xhamiu et Tirmidhi.
E

këshilloj nxënësin e dijes që të lexojë sa më shumë prej tyre, sepse në to ka dy dobi:

E para: Kthimi tek bazat e fesë.

E dyta: Përsëritja e emrave të transmetuesve në mendje, gjë e cila bën që kur të lexosh emrat e transmetuesve në çdo sened që të jenë, e dallon p.sh. se filani është nga transmetuesit e Buhariut, duke

përfiturar kështu këtë dobi në shkencën e hadithit.

Së treti: Në fikh:

01 - Libri **“Edukata e të ecurit për në xhami”**, i shejhut të Islamit Muhamed ibën Abdulvehab, RahimehUllah.

02 - Libri “Zadu el Nustekni, shkurtim i librit “El Mukni”, i El Haxhavi, një nga më të mirat libra të përmbledhura në fikh. Ky është një libër i shkurtuar dhe i përmbledhur, të cilin profesori ynë, dijetari i madh Abdurrahman es Seadi, Allahu e mëshiroftë, na këshilloi që ta mësonim përmendësh, ndërkohë që vetë ai kishte mësuar përmendësh tekstin e librit **“Delijlu et Talib.”**

03 - Libri **“Er raudul murabea, sqarim i “Zadul Mustekni”**, i shejh Mensur el Behuti.

04 - Libri **“Umdetul Fikh”**, i Ibën Kudames, RahimehUllah

Së katërti: Në ndarjen e trashëgimisë:

01 - Libri **“Metnu er Rrahabije”**, i Er Rahabi.

02 - Libri **“Metnul Burhanije”**, i Muhamed el Burhani, një libër i shkurtuar, i dobishëm, përmbledhës për të gjitha trashëgimitë. Për mendimin tim, ky i dyti është më i mirë se libri Er Rrahabije, për shkak se ky është më përmbledhës dhe me njohuri më të zgjeruara.

Së pesti: Në Tefsir:

01 - Libri **“Tefsiri i Kuranit të Madhërishëm”**, i Ibën Kethirit, i cili është i mirë në tefsirin me gjurmët e të parëve, i dobishëm dhe i sigurtë **(për nga akidja, etj)**. Por ai jep shumë pak në lidhje me anën gjuhësore dhe atë retorike.

02 - Libri **“Tejsijr el Kerijmi er Rrahman fi Tefsir Kelamil Menan”**, i shejh Abdurrahman ibën Nasir es Seadi,

RahimehUllah Ky është një libër i mirë, i lehtë për t'u përvetësuar dhe i sigurtë **(për nga akidja, etj)**. Unë këshilloj për leximin e tij.

03 - Libri **“El Mukadimetu fi et Tefsir”**, e shejhut të Islamit Ibën Tejmije, i cili është hyrje e rëndësishme dhe e mirë në shkencën e Tefsirit.

04 - Libri **“Edvaul Bejan”**, i dijetarit të madh Muhamed esh Shinkiti, RahimehUllah Ky është një libër përmbledhës i hadithit, fikhut, tefsirit dhe usuli fikhut.

Së gjashti: Libra të përgjithshme në disa shkenca të ndryshme:

01 - Në sintaksën arabe: **“Metnul Axhrumije”**, një libër i shkurtuar dhe i thjeshtë.

02 - Gjithashtu në sintaksë: **“Elfijtu Ibni el Malik”**, i cili konsiderohet esenca e sintaksës.

03 - Në Sira, libri më i mirë që kam parë

është: **“Zadul Miad”**, i Ibnul Kajim, RahimehUllah Ky është një libër shumë i dobishëm i cili përmend historinë e Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sellem) në të gjitha gjendjet e tij, pastaj nxjerr ligje dhe dobi të shumta.

04 - Libri **“Kopështi i njerëzve të zgjuar”**, i Ibën Hiban el Busti, RahimehUllah Ky është një libër i dobishëm edhe pse është i vogël, dhe ka mbledhur një numër të madh dobishë dhe gjurmë dijetarësh të hadithit e të tjerë.

05 - Libri **“Sijeru ealami en Nubela”**, i Dhehebiut, një libër me dobi shumë të mëdha, nga i cili nxënësi i dijes duhet të lexojë dhe të kthehet tek ai.

Lusim Allahun të na japë dije të dobishme dhe të na bëjë dobi me dijen që na jep! Ai është Zot i kësaj dhe Plotfuqishëm për gjithçka. Mëshira dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dërguarin tonë Muhamed, familjen dhe shokët e tij!